

ZHVILLIMI I SIGURIMEVE PËR PEMË DHE PERIME: NJË FOKUS NË CILËSINË DHE KARAKTERISTIKAT E HUMBJES



Doracaku 9

In a partnership with



WORLD BANK GROUP

IFC International
Finance Corporation

Sigurimet bujqësore dhe menaxhimi i rrezikut: Zhvillimi i produktit dhe vendosja e çmimeve janë përgatitur nga: Dr. Lysa Porth për Korporatën Financiare Ndërkombëtare (KFN)

Materiali në këtë punim është i mbrojtur me të drejtat e autorit. Kopjimi dhe/ose bartja e pjesëve ose tërë këtij punimi pa leje mund të përbëjë shkelje të ligjit në fuqi. KFN e inkurajon shpërndarjen e punës së vet dhe normalisht jep leje për riprodhimin e pjesëve të punimit menjëherë, dhe kur riprodhimi është për qëllime arsimore dhe jo komerciale, pa pagesë, me kusht që të paraqiten atribuimet dhe njoftimet e tilla që mund t'i kërkojmë me arsye. KFN nuk e garanton saktësinë, besueshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së përfshirë në këtë punim, as për konkluzionet ose gjykimet e përshkruara këtu dhe nuk pranon përgjegjësi ose detyrim për ndonjë lëshim ose gabim (duke përfshirë, pa kufizim, gabimet tipografike (të shtypit) dhe gabimet teknike) të çfarëdoshëm në përmbajtje ose për mbështetjen në to. Kufijtë, ngjyrat, emërtimet dhe informacionet e tjera të paraqitura në të gjitha hartat në këtë punim nuk nënkuptojnë ndonjë gjykim nga ana e Bankës Botërore lidhur me statusin ligjor të ndonjë territori ose me aprovimin ose pranimin e kufijve të tillë. Gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura në këtë vëllim nuk pasqyrojnë domosdo pikëpamjet e Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore apo të qeverive që ata i përfaqësojnë. Përmbajtja e këtij punimi është vetëm për qëllime të përgjithshme informative dhe nuk ka për qëllim të përbëjë këshilla juridike, të letrave me vlerë ose të investimeve, as mendim në lidhje me përshtatshmërinë e ndonjë investimi ose një kërkesë të çfarëdo lloji. FNK ose bashkëpunëtorët e saj mund të kenë investim, të ofrojnë këshilla ose shërbime të tjera ose të kenë ndonjë interes financiar në disa prej kompanive dhe palëve (përfshirë ato të përmendura këtu).

Të gjitha pyetjet e tjera mbi të drejtat dhe licencat, duke përfshirë të drejtat subsidiare, duhet të dërgohen në Departamentin e Marrëdhënieve të Korporatave të FNK-së, 2121 Pennsylvania Avenue, N.W., Washington, D.C. 20433.

Korporata Financiare Ndërkombëtare është një organizatë ndërkombëtare e themeluar me Marrëveshjen ndërmjet vendeve anëtare të saj dhe është anëtare e Grupit të Bankës Botërore. Të gjithë emrat, logot dhe markat tregtare janë pronë e KFN-së dhe ju nuk mund ta përdorni asnjë material të tillë për asnjë qëllim pa pëlqimin me shkrim të KFN-së. Përveç kësaj, «Korporata Financiare Ndërkombëtare» dhe «KFN» janë marka tregtare të regjistruara të KFN-së dhe mbrohen me ligjin ndërkombëtar.

© Korporata Financiare Ndërkombëtare 2018. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

2121 Pennsylvania Avenue, N.W.

Washington, D.C. 20433

www.ifc.org

Table of Contents

1.o. Hyrje	5
2.o. Përkufizimet dhe prapavija e sektorit të pemëve dhe perimeve	6
3.o. Pasqyrë e rreziqeve të cilat i hasin kultivuesit e pemëve dhe perimeve	8
3.1. Rreziqet e prodhimit	8
3.2. Rreziqet e marketingut	8
3.3. Rreziqet financiare	9
4.o. Disponueshmëria e sigurimeve dhe sfidat me të cilat përballen sektori i pemëve dhe perimeve ...	10
5.o. Cilësia	14
5.1. Cilësia	14
5.2. Zbulimi i çmimeve	14
5.3. Korrigjimi i humbjeve	15
6.o. Shqyrtim i përgjithshëm i llojeve të sigurimeve	16
6.1. Të bazuara në rendiment	16
6.2. Të bazuara në të hyra	16
6.3. Mallra individuale	16
6.4. Ferma në tërësi	17
6.5. Të bazuara në dëmshpërblime	17
6.6. Të bazuara në indeks	17
7.o. Përvoja ndërkombëtare lidhur me mbulimin me siguri për pemë dhe perime	18
7.1. Të hyrat	18
7.2. Marzha	19
7.3. Bazuar në rendiment (bazuar në prodhim)	20
7.3.1. Me shumë rreziqe	20
7.4. Sigurimi i ri-mbjelljes së pemëve, shkurreve dhe hardhive	24
7.4.1. Programe të tjera	25
7.5. Mbulimi i sëmundjeve specifike	25
7.6. Kooperativat	26
7.7. Humbja e cilësisë	26
7.8. Sigurimet e bazuara në indeks	27
7.9. Ide të së ardhmes - Teknologjia "Blockchain"	27
8.o. Përmbledhje dhe rekomandimet	29
9.o. Referencat	30

Parafjala dhe falenderimet

Doracakët e sigurimeve bujqësore janë përgatitur nga FNK për zhvillimin e tregjeve të agro-sigurimeve ku sektorët publikë dhe privatë punojnë së bashku në partneritet (PPP). Këta doracakë janë të dizajnuar për ta forcuar kapacitetin e qeverisë dhe lojtarëve të tregut për të dizajnuar në mënyrë efektive produktet e agro-sigurimeve, si ato tradicionale në bazë të dëshmipërblimeve ashtu edhe ato në bazë të indeksit, për t'i prezantuar ato në treg dhe për t'i ndërtuar shitjet. Doracakët janë të dizajnuar të jenë koncizë por në të njëjtën kohë të mjaftueshëm për t'i krijuar bazat teknike dhe administrative për një sistem modern të agro-sigurimeve dhe për t'u mundësuar programeve në fazat e hershme të zhvillimit ta planifikojnë mirë sistemin e kërkuar. Në fund, doracakët janë të dizajnuar për t'i trajnuar praktikuesit, për t'i zhvilluar kapacitetet lokale për aftësitë që kërkohen për ta filluar programin dhe për të mundësuar që programi të rritet me kalimin e kohës.

Projekti IFC Europe (KFN Evropë) dhe Projekti i Agro-Financave i Azisë Qendrore, i zbatuar nga KFN-ja, anëtare e Grupit të Bankës Botërore, në partneritet me qeveritë e Austrisë dhe Hungarisë, e ka iniciuar dhe lëshuar këtë doracak për t'i ndarë njohuritë dhe për ta zhvilluar kapacitetin e palëve të interesuara të tregut të agro-sigurimeve. Projekti e përfshin Ukrainën, Azinë Qendrore, Azerbajxhanin dhe Ballkanin Perëndimor dhe udhëhiqet nga Menaxheri i Projektit, Leah Soroka. Ky projekt synon të kontribuojë në zhvillimin e një sistemi financiar bujqësor të qëndrueshëm. Kjo qasje do të ndihmojë për lansimin e mjeteve të reja të financimit dhe menaxhimit të rrezikut, të dizajnuara veçanërisht për kreditimin e sektorit nga ndërmjetësit financiarë dhe instrumenteve të nevojshme për ta përmirësuar menaxhimin e rrezikut të tyre në bujqësi.


I gjithë ekipi i agro-sigurimeve në Ukrainë, Azerbajxhan dhe Kosovë kanë dhënë kontribute praktike në këta doracakë. Një falënderim i veçantë shprehet për Lysa Porth, Ph.D. MBA, Profesoreshë e Asociuar dhe Guy Carpenter, Kryetar i Kërkimeve në Menaxhimin e Rrezikut të Bujqësisë dhe Sigurimeve në Qendrën Warren për Studime dhe Hulumtime Aktuariale, I.H. Asper School of Business, Universiteti i Manitobas, Kanada dhe Andrey Zaripov, specialist i agro-sigurimeve dhe anëtar i ekipit të GIIF për ndihmën në hartimin e doracakëve. Informacioni në këtë doracak bazohet pjesërisht në kërkimet aktuale dhe të kaluara nga Lysa Porth, si ato të botuara edhe ato që janë dokumente punuese. Lysa Porth gjithashtu do të donte të falënderonte për kontributin e dobishëm nga kolegët e saj në AgRiskCentre.com.

1.0. Hyrje

Sigurimi i kulturave tradicionalisht është përqendruar në sektorin e drithërave dhe farave për prodhimin e vajit, që përbëjnë pjesën më të madhe të sipërfaqes bujqësore të siguruar dhe detyrimeve në shumicën e rajoneve anembanë botës. Përqindjet e pjesëmarrjes kanë tendencë që të përkojnë me zhvillimin më të avancuar të menaxhimit të rrezikut dhe produkteve të sigurimit për kulturat tradicionale të drithërave, dhe në disa vende, si në SHBA dhe Kanada, përqindjet e pjesëmarrjes i afrohen nivelit 90% sa u përket prodhuesve të regjistruar ose sipërfaqes së siguruar. Krahasimisht, menaxhimi i rrezikut dhe sigurimi i kulturave të specializuara, që përfshijnë pemët dhe perimet, ka tendencë të jenë më pak të zhvilluara dhe përqindjet e pjesëmarrjes janë gjithashtu shumë më të ulëta në shumë raste. Kjo pabarazi ekziston përkundër asaj se kulturat e specializuara përbëjnë afërsisht një të tretën e të ardhurave të parave në SHBA dhe Kanada.

Ndërsa duket se ka më shumë theks në zhvillimin e zgjidhjeve të reja dhe më efektive të menaxhimit të rrezikut dhe sigurimeve, ka disa sfida në dizajnimin, shitjen dhe shërbimin e sigurimeve të kulturave të specializuara në krahasim me kulturat më homogjene. Vështirësitë përfshijnë përcaktimin e saktë të rendimentit afatgjatë të prodhimit, vlerësimin e cilësisë, vjeljet e shumëfishta të kulturës gjatë kohës, sipërfaqen relativisht të vogël, praktikat shumë të ndryshme të prodhimit, mungesën e zbulimit të çmimeve për disa mallra, përzgjedhjen e pafavorshme dhe rrezikun moral, rreziqet specifike si dhe rreziqet që nuk lidhen me kushtet atmosferike. Prandaj, nevojiten përpjekje më të mëdha kërkimore dhe zhvillimore për të bërë përmirësime kuptimplota në sektorin e kulturave të specializuara.

Pjesa tjetër e këtij doracaku është e organizuar si më poshtë. Më pas, është përkufizuar sektori i kulturave të specializuara, së bashku me informacione të përgjithshme mbi sfondin. Pas kësaj, janë përcaktuar sfidat e sektorit, me përqendrim në krahasimin e kulturave të specializuara me kulturat kryesore të fushave për të mundësuar që të kuptohen më mirë disa prej vështirësive që e kanë bërë më të kufizuar zhvillimin e menaxhimit të rrezikut dhe të sigurimeve, dhe përvetësimin e përhapur të tyre. Pjesa tjetër jep një pasqyrë të llojeve të ndryshme të alternativave të sigurimeve, me theks në prodhimin (sasinë), cilësinë, të ardhurat dhe qasjet e tjera të mundshme. Pjesa tjetër i është dedikuar një diskutimi gjithëpërfshirës mbi korrigjimin e humbjeve dhe vlerësimin e cilësisë. Doracaku përfundon me disa studime të rasteve për të paraqitur disa nga përpjekjet e ndryshme për zhvillim dhe mësimet që duhet të mësohen nga disa nga rajonet kryesore të prodhimit bujqësor në botë.




2.0. Përkufizimet dhe historiku i sektorit të pemëve dhe perimeve

Sektori i pemëve dhe perimeve është mjaft i larmishëm, duke mbuluar shumë mallra të ndryshme dhe të llojllojshme në të gjitha rajonet gjeografike. Prandaj, përkufizimi i sektorit të pemëve dhe perimeve mund të jetë sfidues dhe ky përkufizim ka ndryshuar me kalimin e kohës dhe gjithashtu ndryshon në vende të ndryshme në disa raste. Pemët dhe perimet shpesh grupohen nën përkufizimin e "kulturave të specializuara" dhe në disa raste përkufizohen më gjerësisht si "hortikulturë". Për shembull, në vitin 2001 SHBA-të i përkufizonin kulturat e specializuara sipas Aktit të Asistencës Ekonomike Bujqësore të vitit 2001 si "çdo kulturë bujqësore, përveç grurit, drithërave për ushqim të kafshëve, farërave për prodhim të vajit, pambukut, orizit, kikirikëve dhe duhanit". Në vend që të përkufizohen kulturat e specializuara sipas asaj që nuk janë, në vitin 2004, Akti i Konkurrencës së Kulturave të Specializuara i SHBA-së e rafinon përkufizimin në "pemë, perime, fruta arrore, fruta të thata dhe bimët dekorative (duke përfshirë edhe lulishtet)". Në vitin 2008, Shtetet e Bashkuara e specifikuan më tej përkufizimin, që është ai që aktualisht përdoret sot në SHBA, si "fruta, perime, fruta arrore, fruta të thata, m, dhe bimë dekorative (përfshirë lulishtet)". Brenda kësaj liste të kulturave të specializuara, Shërbimi i Marketingut Bujqësor (AMS) në SHBA i përshkruan më shumë se 300 mallra. Në Kanada, sektori i pemëve dhe perimeve kategorizohet si hortikulturë dhe mbulon më shumë se 120 mallra në të gjithë vendin. Në përgjithësi, Kanadaja ka dy kategori për hortikulturë, duke përfshirë: 1) prodhimin e pemëve dhe perimeve (jo-në serrë), dhe 2) prodhimin lidhur me produktet e panjës, kërpudhat, serrat, barin dhe fidanishtet. Mënyra të tjera për t'i klasifikuar kulturat e hortikulturës janë si të ngrënshme që kultivohen për ushqim të njeriut që konsumohen të freskëta ose përpunohen në produkte me vlerë të shtuar ose jo-të ngrënshme që nuk përdoren si ushqim por prodhohen për qëllime të tjera.

Prodhimi global i pemëve dhe perimeve ka realizuar rritje të konsiderueshme dhe ky sektor është duke u njohur gjithnjë e më shumë si kontribuues i rëndësishëm për dietën e shëndetshme. Një listë e gjerë e përfitimeve është lidhur me pemët dhe perimet duke përfshirë zvogëlimin e rasteve të sëmundjeve kronike dhe jo-ngjitëse, duke përfshirë sëmundjet kardiovaskulare dhe kancerin. Këto përfitime të rëndësishme shëndetësore kanë kontribuar në rritjen e kërkesës për pemë dhe perime të freskëta gjatë gjithë vitit, jo vetëm në kohën e vjeljes. Përveç kësaj, forca të tjera të nxitjes së kërkesës, të tilla si ndryshimi i demografisë, kanë çuar gjithashtu në rritjen e prodhimit të pemëve dhe perimeve.

Rritja e përgjithshme e prodhimit botëror është nxitur kryesisht nga zgjerimi i sipërfaqes në Azi, veçanërisht në Kinë, e cila tani është prodhuesi më i madh në botë i pemëve dhe perimeve. Kina është prodhuesi më i madh në botë i pemëve dhe perimeve. Kina ka klima të ndryshme dhe lloje të ndryshme të dheut dhe ka kapacitet të madh për të prodhuar një shumëllojshmëri të pemëve dhe perimeve. Shandong është rajoni më i madh i prodhimit për pemë dhe perime në Kinë, dhe provinca Tianjun ka një sektor energjik të serrave. Shkalla e shpejtë e rritjes së kultivimit të pemëve dhe perimeve është njohur edhe në rajonet me të ardhura të ulëta, si Afrika Nën-Sahara dhe Azia Jugore, ku prodhimi i hortikulturës siguron kthime të larta ekonomike për njësi të sipërfaqes së tokës. Përveç zgjerimit të sipërfaqes, ky sektor gjithashtu ka përfituar nga ndryshimi i praktikave bujqësore, siç është zbatimi gjithnjë e më shumë i rritjes së makinerive.

Megjithë rritjen e sektorit, konsumi i pemëve dhe perimeve është ende nën nivelet e synuara për të arritur përfitime shëndetësore në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim.





Prandaj, mbetet mundësi e madhe për tapërmirësuar sasinë, cilësinë dhe shpërndarjen e pemëve dhe perimeve të freskëta, megjithatë ka sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Biznesi i bujqësisë është i njohur si me rrezik, dhe për kulturat kryesore moti i keq, si thatësia apo përmbytjet, mund të jenë përgjegjës për madje 70-90% të humbjeve të kulturës. Megjithatë, në rastin e pemëve dhe perimeve, jo vetëm që moti ekstrem është rrezik kryesor, por edhe prodhuesit përballen me sfida lidhur me qasjen në treg, prishjen e produkteve (humbja pas vjeljes), etj. Një tjetër sfidë madhore me të cilën përballen prodhuesit e pemëve dhe perimeve është mungesa e sigurimeve, veçanërisht kur krahasohet me sigurimet për kulturat e grurit, për të cilat ka dukshëm më shumë sigurime të përhapura në shumicën e rajoneve të botës. Hulumtimet kanë treguar se pa sigurim adekuat, është më e vështirë të rritet prodhimi. Kjo ndodh për shkak se bujqit e përdorin sigurimin e kulturës si një mekanizëm për t'i stabilizuar të ardhurat e tyre, që u ndihmon që të rimëkëmben nga ndodhi të padëshiruara si fatkeqësitë natyrore, luhatjet e paqëndrueshme të tregut etj. Rrjedha më e qëndrueshme e parave u ndihmon prodhuesve në blerjen e faktorëve të prodhimit nga një sezon në tjetrin, si dhe në investimet në pajisje dhe teknologji të reja për ta rritur efikasitetin e tyre të prodhimit, ndër përfitimet e tjera. Prandaj, shumë bujq e shohin sigurimin e kulturave si menaxhimi kryesor i rrezikut dhe politika e tyre. Prandaj, mungesa e sigurimit për prodhuesit e pemëve dhe perimeve ka gjasa të jetë pengesë kryesore në rritjen e prodhimit nga këto ferma. Nëse të gjitha të tjerat janë të barabarta, bujqit kanë më pak gjasa të kultivojnë kultura që nuk mund të sigurohen dhe kjo krijon një cikël ku polisat e sigurimit ka më pak gjasa të zhvillohen për kulturat që nuk mbillen në një bazë të përhapur gjerë.

3.0. Përmbledhje e rreziqeve me të cilat përballen kultivuesit e pemëve dhe perimeve

Rreziqet me të cilat ballafaqohen prodhuesit e drithërave, duke përfshirë ndryshueshmërinë e çmimeve dhe të rendimenteve, janë studiuar gjerësisht nga hulumtuesit (shih për shembull Sherrick et al., 2004). Në përgjithësi, rreziqet zakonisht mund të kategorizohen si rreziqe të prodhimit, marketingut, financiare, ligjore dhe mjedisore, dhe rreziqet e menaxhimit të burimeve njerëzore. Për krahasim, disa studime i kanë shqyrtuar rreziqet me të cilat përballen prodhuesit e pemëve dhe perimeve, dhe në veçanti miratimin e mjeteve të menaxhimit të rrezikut nga kultivuesit e pemëve dhe perimeve. Ali dhe Kapoor (2008) konstatojnë se moti i keq është rreziku më i përhapur i prodhimit me të cilin përballen prodhuesit e pemëve dhe perimeve dhe çmimet e larta të faktorëve të prodhimit, çmimet e ulëta të produkteve dhe prishja e shpejtë e produkteve perceptohen si rreziqet më të larta brenda kategorisë së rrezikut të tregut. Sciabarrasi (2018) jep një pasqyrë të pesë llojeve kryesore të rreziqeve që kanë të bëjnë me prodhuesit e pemëve dhe perimeve. Tri rreziqet e para, të prodhimit, marketingut dhe financiar, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me aplikimet për sigurime dhe menaxhimin e rrezikut, janë prezantuar shkurt në vijim dhe ky vështrim ndjek punën e bërë nga Sciabarrasi (2018).


3.1. Rreziqet e prodhimit

Rreziku i prodhimit në mënyrë tipike korrespondon me rrezikun që rendimenti i vitit aktual të jetë më i ulët se rendimenti mesatar afatgjatë (d.m.th rendimenti i pritshëm). Përveç mungesës së rendimentit, rreziqet e prodhimit mund të përfshijnë edhe humbjen lidhur me uljen e cilësisë. Në rastin e pemëve dhe perimeve, humbja e cilësisë mund të ketë rrezik të konsiderueshëm në çmimin që e merr prodhuesi dhe për këtë arsye cilësia është një shqetësim madhor për shumë prodhues. Cilësia nënkupton përsosmërinë e një produkti, dhe gjithashtu i referohet përshtatshmërisë së tij që të përdoret për një qëllim të caktuar. Cilësia përbëhet nga shumë veti dhe karakteristika të ndryshme, të cilat mund të jetë e vështirë të vlerësohen, duke përfshirë vetitë shqisore si pamja, struktura, shija, era, si dhe vlera ushqyese të tilla si vetitë kimike, mekanike dhe funksionale dhe defektet. Burimet kryesore të rreziqeve të prodhimit janë për shkak të motit të keq, siç janë thatësitrat, ngricat, reshjet e tepërta në kohën e vjeljes, etj. Insektet dëmtuese dhe sëmundjet gjithashtu mund të çojnë në rreziqe të prodhimit.

Në përgjithësi, për të ndihmuar në tejkalimin e rreziqeve të prodhimit, prodhuesit mund të mbështeten në parimet e diversifikimit, praktikave të përmirësuara të menaxhimit dhe transferimit e rrezikut. Për shembull, prodhuesit mund ta diversifikojnë biznesin e tyre duke kultivuar kultura të ndryshme (diversifikimi i produktit) ose duke i diversifikuar gjeografikisht kulturat e tyre (diversifikimi gjeografik). Disa prodhues mund të përpiqen edhe ta zvogëlojnë rrezikun përmes praktikave të tilla si rritja intensive, ujitja, etj. Pavarësisht disa mekanizmave për t'i zvogëluar rreziqet e prodhimit, duke përfshirë diversifikimin dhe praktikave të përmirësuara të menaxhimit, një sasi e madhe e rrezikut mbetet më tutje në shumë raste. Prandaj, transferimi i rrezikut mund të jetë i nevojshëm për disa prodhues, dhe metodat tradicionale të sigurimeve zakonisht janë të përshtatshme për të ndihmuar në uljen e këtij rreziku.

3.2. Rreziqet e Marketingut

Rreziqet e marketingut zakonisht përfshijnë të ardhurat më të ulëta, të cilat mund të jenë për shkak të shitjeve më të ulëta dhe/ose çmimeve më të ulëta. Kjo mund t'i atribuohet faktorëve të tillë si preferencat e klientëve që ndryshojnë, më shumë konkurrencë nga kultivuesit e tjerë, vështirësi me qasjen në treg (blerësi me shumicë ose përpunuesi) ose nëse një produkt nuk i plotëson standardet e tregut ose kërkesat e paketimit. Kultivuesit e pemëve dhe perimeve përballen me disa sfida në marketingun e suksesshëm të prodhimeve të tyre, duke përfshirë shpërndarjen të blerësit në vendin, kohën dhe në formën që e duan blerësit. Produkti nuk mund të ruhet për periudha të gjata kohore, mund të kërkohet fuqi e madhe punëtore për kultivimin dhe vjeljen e kulturave, dhe nganjëherë çmimet




mund të jenë shumë të lëvizshme. Prandaj, marketingu i suksesshëm i pemëve dhe perimeve shpesh është më i vështirë në krahasim me mallrat e tjera bujqësore.

Prodhuesit shpesh ndihmojnë në tejkalimin e rreziqeve të marketingut përmes formimit të kooperativave, hyrjes në marrëveshje të ndryshme kontraktuese dhe transferimit të rrezikut. Për shembull, prodhuesit mund të formojnë ose të bashkohen në kooperativa të marketingut dhe kjo mund të ndihmojë për të siguruar çmime më të larta ose për ta garantuar tregun. Prodhuesit gjithashtu mund të ndihmojnë në uljen e rreziqeve të marketingut duke lidhur kontrata të shitjes ose të çmimeve me blerësit, duke diversifikuar dhe bërë marketing për produktet përmes kanaleve të shumta të shitjeve dhe duke rritur aktivitetet e drejtpërdrejta të marketingut. Përkundër këtyre metodave për zvogëlimin e rreziqeve të marketingut, transferimi i rrezikut tek një palë e tretë është gjithashtu me rëndësi për shumë fermerë. Në veçanti, sigurimi i bazuar në të ardhura mund të përdoret nga prodhuesit për t'i mbuluar rëniet e papritura të çmimit të marketingut gjatë vitit të sigurimit.

3.3. Rreziqet financiare

Si pasojë e rreziqeve të prodhimit dhe marketingut, mund të ndodhin edhe rreziqet financiare. Shpesh kjo do të thotë që fermerët nuk kanë para të mjaftueshme për t'i përmbushur detyrimet e pritshme. Rreziqet financiare mund të shkaktohen nga ngushtimi i marzhës së fitimit, shpesh për shkak të rritjes së kostos së faktorëve të prodhimit, si dhe normave më të larta të interesit, normave të pafavorshme të këmbimit etj. Për të ndihmuar në trajtimin e rrezikut financiar, prodhuesit mund të përpiqen t'i kontrollojnë shpenzimet kryesore të fermës, dhe të gjejnë faktorë alternativë të prodhimit. Në disa raste, prodhuesit përpiqen ta stabilizojnë rrjedhën e parasë duke gjetur punë jashtë fermës. Meqenëse rreziqet financiare mund të jenë të konsiderueshme, bartja e rrezikut financiar tek një palë e tretë mund të jetë një strategji shumë e rëndësishme e uljes së rrezikut. Llojet e ndryshme të polisave të sigurimit mund të ndihmojnë për të ardhura stabile të prodhuesit. Sigurimi i bazuar në prodhim dhe në të ardhura janë diskutuar më lart, dhe përveç kësaj, sigurimi i fermës në tërësi mund të jetë një alternativë tjetër e dobishme për kultivuesit. Sigurimi i fermës në tërësi nuk e siguron një kulturë individuale, por siguron prodhimin (dhe mundësisht edhe të ardhurat) nga të gjitha kulturat e kultivuara në fermë, duke mbuluar humbjen e rendimentit (dhe mundësisht çmimet e tregut në ulje).



4.0. Disponueshmëria e sigurimeve dhe sfidat përballë sektorit të pemëve dhe perimeve

Pavarësisht nga rëndësia e sektorit të pemëve dhe perimeve në mbarë botën, oferta e sigurimit të kulturave është relativisht e kufizuar krahasuar me atë për kultivuesit e kulturave kryesore të grurit. Siç u diskutua më parë, disponueshmëria e sigurimit adekuat mund të jetë një faktor kryesor që prodhuesit të vendosin të kultivojnë produkte të caktuara. Prandaj, në rastin e pemëve dhe perimeve mungesa e qasjes në mjetet për menaxhimin e rrezikut dhe sigurimeve mund të jetë një pengesë e mundshme për zgjerimin e tyre. Në disa rajone, duket të ketë një përqendrim në rritje në zhvillimin e produkteve të sigurimit të kulturave për kulturat e specializuara, duke përfshirë për pemët dhe perimet. Megjithatë, ka shumë ferma të pemëve dhe perimeve pa një polisë sigurimi të kulturës në dispozicion. Kjo mund të jetë veçanërisht e vërtetë për fermat që prodhojnë një larmi të kulturave të pemëve dhe perimeve.

Në Shtetet e Bashkuara, ligji për fermat i vitit 2014 përqendrohet më shumë në përpjekjet për zhvillim të kulturave të specializuara për programin federal të sigurimit të kulturave. Agjencia e Menaxhimit të Rrezikut (RMA) e USDA raporton se primet e sigurimit të kulturave të specializuara janë rritur nga 7.5 miliardë dollarë në 2000 në 15.5 miliardë dollarë në vitin 2015 dhe në vitin 2015 është theksuar se rreth 73% e sipërfaqes së dedikuar për prodhimin e kulturave të specializuara ka qenë e mbuluar me programet federale të sigurimit të kulturave (FCIC, 2015). Aktualisht USDA-RMA ka polisa për të mbuluar përafërsisht 38 kultura të specializuara, dhe programe pilot aktive për edhe 30 kultura të tjera. Në një përpjekje për t'i përmirësuar mjetet e sigurimit dhe menaxhimit të rrezikut për sektorin e kulturave të specializuara, USDA bëri një thirrje për zhvillimin e mbrojtjes së të ardhurave të fermës në tërësi, veçanërisht për prodhuesit e kulturave të specializuara.

Në Kanada, Grupi Punues Federal-Provincial-Territorial (FPT) i Agro-Sigurimeve (AIWG) identifikoi se mangësitë lidhur me sigurimin e prodhimit të hortikulturës ishin prioritet (AAFC, 2012). AIWG vazhdon të punojë me prodhuesit e pemëve dhe perimeve të freskëta për t'i trajtuar sfidat në zhvillimin e planeve që i plotësojnë nevojat e këtyre kultivuesve. Është raportuar se shkalla e pjesëmarrjes së kultivuesve të pemëve dhe perimeve në Kanada është rritur nga 51.1% në 2008 në 61.5% në 2010, që e tejkalon qëllimin e përcaktuar të qeverisë për 60% pjesëmarrje në këtë sektor. Megjithatë, shoqatat e prodhuesve kanë komunikuar se kjo përqindje e pjesëmarrjes kryesisht përfaqëson kulturat e hortikulturës për përpunim, dhe jo për prodhimin e pemëve dhe perimeve të freskëta. Kjo ka gjasa sepse të dhënat e përpunimit të çmimeve janë më në dispozicion krahasuar me ato të produkteve të freskëta, pasi që përcaktohet përmes kontratave dhe rendimenteve bazuar në vëllimin e shpërndarjes tek përpunuesi, që është një sfidë e diskutuar më në detaje në pjesën e ardhshme të punimit.

Një pjesë e arsyes për zhvillimin më të kufizuar të produkteve të sigurimeve për kulturat e specializuara, përfshirë për pemët dhe perimet, është për shkak të sfidave të veçanta me të cilat përballet sektori në krahasim me kulturat kryesore. Për shembull, disa kultura të specializuara kanë vështirësi në lidhje me sipërfaqen e përgjithshme të vogël të dedikuar prodhimit (d.m.th vështirësi me ekonominë e shkallës), mungesë të të dhënave që krijojnë probleme me analizat aktuariale, ndryshueshmëria dhe zbulimi i çmimeve, ndryshueshmëri brenda sektorit në matjen e rendimenteve dhe cilësisë, mungesa e kërkesës nga kultivuesit për shkak të metodave alternative të vetë-sigurimit, dhe çështje të tjera. Kjo mund të kontribuojë në më shumë vështirësi në zhvillimin e sigurimeve, mund t'i kufizojë nivelet e mbulimit dhe në disa raste mund të nënkuptojë që disa kultura të specializuara nuk mund të sigurohen. Secila prej sfidave janë përshkruar më në detaje më poshtë.




a. Sipërfaqet e vogla

Është dokumentuar mirë, madje edhe për kulturat kryesore të drithërave, se ekzistojnë ekonomi të shkallës sa i përket sigurimit dhe administrimit kur fermat janë me madhësi më të madhe. Kjo ndodh shpesh në rajonet më të zhvilluara, si Kanadaja dhe SHBA, krahasuar me rajonet në zhvillim, të cilat zakonisht kanë numër më të madh të fermave shumë të vogla. Në rastin e fermave shumë të vogla, primet e sigurimit të kulturave bujqësore mund të jenë tepër të shtrenjta dhe prandaj pjesa më e madhe e theksit të përpjekjeve kërkimore dhe zhvillimore në vendet në zhvillim ka qenë në sigurimet sipas indeksit. Në rastin e kulturave të specializuara, si në rajonet e zhvilluara edhe ato në zhvillim, më së shpeshti ndodh që ato kultivohen në sipërfaqe relativisht të vogla. Përveç kësaj, kjo mund ta bëjë më të vështirë të zhvillohen standardet e sigurimeve dhe vlerësimet aktuariale. Prandaj, shpenzimet e sigurimit dhe të administrimit që lidhen me fermat e pemëve dhe perimeve mund të jenë relativisht të larta, duke çuar në primet më të larta të sigurimeve dhe ndoshta në nevojën për mbështetje më të madhe nga qeveria. Përveç kësaj, sipërfaqet e vogla për fermat e pemëve dhe perimeve mund të kenë kosto më të larta operationale sa i përket marketingut dhe shitjes së kulturave, si dhe kostot e faktorëve të prodhimit (ekonomitë e shkallës). Shkurtimisht, kjo mund ta kufizojë realizueshmërinë e sigurimit të qëndrueshëm nga ana komerciale në disa raste për shkak të primeve që janë shumë të larta.

b. Mungesa e të dhënave dhe problemet aktuariale

Në literaturë është dokumentuar mirë se sektori i bujqësisë përballet me një sërë sfidash lidhur me mungesën e të dhënave dhe besueshmërinë e tyre për t'i parashikuar rendimentet dhe humbjet, që është një funksion qendror për zhvillimin, vlerësimin dhe kryerjen e një analize aktuariale të mirë. Megjithatë, në rastin e kulturave të specializuara kjo sfidë mund të rritet më tej. Për shembull, shpesh është shumë e vështirë të sigurohen të dhëna të sakta mbi rendimentet e prodhuara dhe çmimet e marra për pemët dhe perimet. Kjo për shkak se disa prodhues shesin direkt tek konsumatorët (në fermë ose nëpërmjet tregjeve të fermerëve), dhe në shumë raste, pemët dhe perimet kanë shumë çmime shumë të ndryshme, veçanërisht në periudhën afatshkurtër që i atribuohet prishjes së produktit, dhe më pas furnizimit dhe kërkesës aktuale në treg. Më tej, cilësia është shpesh një shqyrtim i rëndësishëm në prodhimin e pemëve dhe perimeve, që shpesh është sinonim me çmimin. Për fat të keq, nuk është gjithmonë e thjeshtë të përcaktohet nëse prodhimi është me "cilësi të lartë" dhe gjykimi i cilësisë shpesh ndryshon nga një vit në tjetrin. Standardet federale apo ndërkombëtare nuk ekzistojnë për të gjitha pemët dhe perimet, dhe madje edhe kur ato ekzistojnë shpesh nuk janë shumë specifike. Për shembull, në SHBA ka zakonisht vetëm një gradë cilësie që konsiderohet, që është në SHBA nr. 1, dhe kjo i referohet produktit që është "me cilësi të mirë mesatare". Matja e rendimentit gjithashtu mund të jetë sfidë në rastin e pemëve dhe perimeve. Një shembull i kësaj sfide është për pemët dhe perimet që vazhdimisht japin fryte, të tilla si dredhëzat, kungulleshkat, etj. Prandaj, aktuarëve shpesh u paraqitet sfida e të dhënave të kufizuara për të dizajnuar produkte të sigurimeve dhe për të llogaritur primet për kulturat e specializuara.

Këto sfida aktuariale mund të jenë me interes të madh sepse gabimet mund të çojnë në çmim shumë të lartë ose shumë të ulët, në krahasim me nivelin e vërtetë të rrezikut. Primet tepër të larta mund të çojnë në pjesëmarrje të ulët, gjë që mund të çojë në përzgjedhje të pafavorshme. Ngjashëm, nëse primet janë shumë të ulëta, përzgjedhja e pafavorshme mund të shkaktojë shpenzime të tepërta të programit, që e bën programin jo të qëndrueshëm në periudhën afatgjatë. Përveç kësaj, mungesa e informacionit gjithashtu mund ta bëjë të vështirë vendosjen e niveleve adekuate të mbulimit. Për shembull, kur të dhënat janë të kufizuara, aktuarët priren të jenë më pak të sigurt në analizë dhe janë më konservatorë në analiza, që shpesh rezultojnë në nivele më të ulëta të mbulimit. Nga një rishikim i literaturës në lidhje me dizajnin e polisave për pemët dhe perimet, duket se nivelet e mbulimit mund të jenë më të ulëta në krahasim me kulturat kryesore të drithërave, me mbulueshmëri maksimale afërsisht 75%, në krahasim me atë më të lartë 90%, në shumë raste. Mbulimi më i lartë në dispozicion për kulturat e drithërave mund të jetë pjesërisht për shkak të informacionit relativisht më të saktë dhe më të plotë që i jep aktuarit më shumë besim në përcaktimin e humbjeve të pritura, llogaritjen e normave të sakta të primit dhe vendosjen e rezervës aktuariale.





c. Ndryshueshmëria dhe zbulimi i çmimeve

Dy llojet më të njohura të produkteve të sigurimit të kulturave në të gjithë globin janë shpesh planet sipas prodhimit dhe sipas të hyrave. Në të dyja rastet, krahas matjes së mungesës së rendimentit (mungesa e rendimentit në vitin aktual në raport me një rendiment mesatar afatgjatë), çmimi është një komponent i rëndësishëm i këtij modeli. Për planet sipas prodhimit, mungesa në prodhim shumëzohet me çmimin e pritur të kulturës, që përcaktohet në datën e fillimit të polisës. Në rastin e planeve sipas të hyrave, jo vetëm që prodhuesit marrin mbulim për mungesën e prodhimit, por ata gjithashtu kompensohen për uljen e çmimeve gjatë periudhës së polisave. Prandaj, si në planet sipas prodhimit ashtu edhe në ato sipas të hyrave, është e nevojshme të parashikohen çmimet në mënyrë transparente, të besueshme dhe të sigurtë.

Për prodhimet e drithërave kryesore, çmimet kanë tendencë të jenë më transparente dhe lehtë në dispozicion, si shembull mekanizmat e zbulimit të tregut të bazuar në Bursën Tregtare në Çikago (CME). Në Shtetet e Bashkuara, planet e bazuara në prodhim përfshijnë Mbrojtjen e Rendimentit (YP) dhe Historinë e Prodhimit Aktual (APH), dhe dallimi kryesor ndërmjet këtyre është se si përcaktohet çmimi. Për shembull, kulturat e mbuluara përmes YP kanë çmim të përcaktuar përmes bursës së këmbimit të mallrave, ndërsa plani APH është në dispozicion për kulturat që nuk kanë çmime të përcaktuara nga një bursë e shkëmbimit të mallrave dhe në vend të kësaj çmimi për APH përcaktohet nga RMA bazuar në një model të parashikimit. Për pemët dhe perimet, jo vetëm që nuk ka tregje mallrash për t'i vëzhguar çmimet e pritshme, por ka edhe disa vështirësi në parashikimin e çmimeve me mjete të tjera (siç është rasti me polisat APH në SHBA). Për shembull, pemët dhe perimet e freskëta mund të kenë ndryshueshmëri të konsiderueshme në çmime, duke përfshirë ndryshueshmërinë ndërmjet prodhuesve në të njëjtin vit, nga një prodhues brenda vitit, si dhe nga një vit në tjetrin.

d. Ndryshueshmëria e sektorit për matjen e humbjeve dhe vlerësimin e cilësisë

Lidhur ngushtë me sfidat aktuale të diskutuara më lart në lidhje me mungesën e të dhënave, ndryshueshmëria e sektorit të pemëve dhe perimeve mund të krijojë disa sfida. Siç u përmend më lart në doracak, ka më shumë se 300 mallra brenda kategorisë së kulturave të specializuara të listuara nga Shërbimi i Marketingut Bujqësor (AMS) në SHBA Përveç ndryshueshmërisë së konsiderueshme në mallrat e prodhuara, kultivuesit e pemëve dhe perimeve shpesh ndryshojnë përzjerjen e produkteve që i kultivojnë mjaft shpejt, si brenda vitit aktual ashtu edhe nga një vit në tjetrin. Kjo mund ta bëjë të vështirë krijimin e niveleve afatgjata të prodhimit, të cilat janë të nevojshme për të dizajnuar produkte të sigurimeve bujqësore (për t'i identifikuar devijimet nga prodhimi afatgjatë). Për më tepër, përcaktimi i humbjeve mund të jetë i ndërlikuar, duke pasur parasysh kulturat, varietetet, drurët shumëvjeçarë, etj. shumë të larmishëm. Përveç kësaj, kuptimi, matja, vlerësimi dhe sigurimi i humbjeve të cilësisë janë gjithashtu sfida të mëdha, dhe kjo intensifikohet në situatën kur janë 300 mallra, të cilat gjithashtu mund të shfaqin karakteristika të ndryshme të humbjes.

e. Ndryshueshmëria në praktikat e menaxhimit (Ndryshueshmëria e praktikave të kultivimit)

Për kulturat kryesore me sipërfaqe të mëdha, praktikat e menaxhimit kanë tendencë të jenë më të njëjtrajtshme me praktikat më të mira të krijuara. Kjo do të thotë se shpesh ka më shumë konsistencë në praktikat e menaxhimit në të gjitha sipërfaqet e një prodhuesi të caktuar, si dhe nga një prodhues në tjetrin. Për krahasim, për pemët dhe perimet shpesh ka variacion shumë më të madh në praktika, dhe kulturat sillen në mënyrë të veçantë, secili lloj i kulturës në krahasim me tjetrin.

Për shembull, disa kultura mund të kërkojnë rotacione të ndryshme, gjerësi të ndryshme ndërmjet rreshtave, ndër-mbjellje të ndryshme etj., dhe numri i madh i variablave dhe ndikimi përkatës në prodhim mund të jetë i vështirë për t'u modeluar dhe kuptuar, gjë që është e nevojshme për zhvillimin e produkteve të qëndrueshme dhe të arsyeshme nga ana komerciale.



f. Mungesa e kërkesës

Ngjashëm me prodhuesit e blegtorisë, për disa prodhues të pemëve dhe perimeve, rreziqet e motit dhe sëmundjeve mund të mos jenë aq shqetësuese në krahasim me prodhuesit e kulturave kryesore të drithërave, duke pasur parasysh se ka disa mënyra alternative për ta menaxhuar rrezikun. Për shembull, prodhuesit e pemëve dhe perimeve mund të përqendrohen në ujitje dhe diversifikim me qëllim që të ndihmojnë menaxhimin e disa prej rreziqeve me të cilat përballen. Këto mënyra të vetë-sigurimit mund të jenë të preferueshme në krahasim me blerjen e sigurimeve në disa raste.

Një çështje tjetër është se për disa kultivues, mund të ketë shqetësim vetëm për një rrezik të caktuar (dhe jo shumë rreziqe). Kjo është për shkak se prodhuesit e pemëve dhe perimeve mund të kenë qasje të preferuara për menaxhimin e rreziqeve të caktuara, duke lënë dëshirë për t'u siguruar vetëm kundër rreziqeve të veçanta. Për shembull, ujitja mund t'u ndihmojë prodhuesve ta menaxhojnë rrezikun nga thatësia. Në vend që të paguajnë premium për një polisë për shumë rreziqe, prodhuesi mund të mos dëshirojë ta mbulojë rrezikun e thatësirës dhe në vend të kësaj dëshiron ta mbulojë një rrezik të vetëm, për shembull si ngrirja në pranverë. Në përgjithësi, mbulimi për një rrezik të vetëm ka çmim më të lirë krahasuar me atë për mbulimin e shumë rreziqeve, dhe kjo mund të jetë e dëshirueshme për disa kultivues. Kjo mund ta shpjegojë pjesërisht mungesën relative të kërkesës për sigurime për pemët dhe perimet. Prandaj, hulumtimet në të ardhmen mund të përqendrohen në produktet që mbulojnë vetëm një rrezik për këtë sektor të specializuar.

g. Tjera

Çështje të tjera që mund të jenë faktorë të rëndësishëm në zhvillimin e produkteve të qëndrueshme dhe përfaqësuese të sigurimeve për sektorin e pemëve dhe perimeve, mund të përfshijnë madhësinë e kufizuar të tregut, si dhe rreziqet që nuk lidhen me kushtet atmosferike. Në shumë raste tregu i pemëve dhe perimeve është relativisht i vogël në përmasa, duke çuar në një treg të "hollë" ose "të ngushtë". Kjo do të thotë se ekziston mundësia që çmimet të ndryshojnë në mënyrë dramatike madje edhe me ndryshime të vogla në furnizim. Për shembull, nëse sigurimi i kulturave inkurajon më shumë prodhim, mund të ketë potencial për ndikime të konsiderueshme në të ardhurat e prodhuesit për shkak të ndryshimeve potencialisht të zmadhuara të çmimeve nga ndjeshmëria e tregut.

Në rastin e rreziqeve që nuk lidhen me kushtet atmosferike, disa kultivues mund të përballen me rreziqe të mëdha që nuk kanë lidhje me motin. Kjo do të thotë se disa polisa të sigurimit që përqendrohen kryesisht në mbulimin e rreziqeve të motit nuk do të funksionojnë për atë kultivues. Për shembull, prodhuesit e kulturave të specializuara mund të përballen me rrezik për shkak të çështjeve të sigurisë së ushqimit që mund të ndikojnë në kërkesën për ato produkte.

Ngjashëm, mungesat e fuqisë punëtore mund të ndikojnë negativisht në procesin e mbjelljes ose vjeljes që çon në rrezik për kultivuesit. Në të dy rastet, çështjet e sigurisë së ushqimit dhe mungesa e fuqisë punëtore shpesh nuk mund të sigurohen¹.

¹ Ndërsa çështjet e sigurisë së ushqimit zakonisht nuk mund të sigurohen, në disa raste vështirësitë me sigurinë e ushqimit mund të çojnë në rënie të çmimit të tregut, dhe rënia e çmimit mund të mbulohet për disa polisa të sigurimit.

5.0. Cilësia

Problemet dhe vështirësitë e korrigjimit të humbjeve që ndikojnë në pemë dhe perime.

Në këtë pjesë diskutohen vështirësitë për korrigjimin e cilësisë dhe humbjes, duke përfshirë atributet dhe standardet e cilësisë, si dhe faktorët që kontribuojnë para dhe pas vjeljes. Pastaj, procesi i korrigjimit të humbjeve të sigurimit bazë është përshkruar në kontekstin e sfidave që ndikojnë në pemë dhe perime.

5.1. Cilësia

Siç u diskutua më sipër, rreziqet e prodhimit përfshijnë humbjen e të ardhurave për shkak të rënies së cilësisë. Megjithatë, në shumë raste, produktet e sigurimit të zhvilluara për pemë dhe perime nuk ofrojnë mbulim adekuat për humbjen e cilësisë. Një arsye kryesore për këtë zbrazëti të mbulimit është për shkak të faktit se cilësia mund të jetë e vështirë për t'u përkufizuar, me disatribute që kontribuojnë në atë që perceptohet të jetë cilësi e lartë. Dukja e pemëve apo perimeve është një nga karakteristikat kryesore të cilësisë. Kjo mund të përfshijë defektet morfologjike, fizike, të temperaturës dhe patologjike. Atribute të tjera të cilësisë përfshijnë strukturën, aromën, dhe vlerën ushqyese, ndër të tjera. Duke pasur parasysh se ekzistojnë disa lloje të ndryshme tëtributeve të cilësisë, në shumë raste ato mund të jetë e vështirë të vlerësohet, dhe zhvillimi i vlerësimit të standardizuar të cilësisë mund të jetë shumë sfidues. Standardi më bazë i cilësisë është që prodhimi të jetë i ngrënshtëm dhe prandaj duhet të mos ketë sëmundje dhe të mos jetë i dëmtuar rëndë. Në Kanada, si shembull, klasat e tregut janë të përcaktuara në Rregulloret e Pemëve dhe Perimeve të Freskëta në Kanada (C.R.C., c. 285, 2018). Këto rregullore përfshijnë një pjesë për gradët dhe standardet, të cilat janë të ndara sipas llojeve specifike të kulturave dhe madje edhe sipas rreziqeve në disa raste, si për shembull, standardet e gradimit të breshërit.

Ngjashëm, në SHBA Shërbimi i Marketingut Bujqësor i USDA-së jep standardet për çdo lloj kulture individuale dhe polisat e sigurimit që janë zhvilluar në SHBA i cekin këto standarde (AMS, 2018). Duhet të theksohet se këto standarde përfshijnë një listë mjaft të gjerë, dhe kjo mund ta bëjë të vështirë për t'u zbatuar në kontekstin e dizajnit të polisave të sigurimit dhe trajnimit të korrigjuesve të humbjeve, si shembull.

Përveç zhvillimit të standardeve të cilësisë, ka edhe disa faktorë para dhe pas vjeljes që mund të kontribuojnë ndjeshëm në cilësinë e përgjithshme të pemëve dhe perimeve të freskëta. Për shembull, faktorët gjenetikë, kushtet klimatike, koha dhe metoda e vjeljes, etj., janë faktorë para-vjeljes. Faktorët siç janë mosha dhe pjekuria që përshkruajnë karakteristikat e vjeljes dhe koha e ruajtjes ndërmjet vjeljes dhe konsumit, si dhe metodat e trajtimit, janë pas vjeljes. Kur zhvillohen produktet e sigurimeve, këta faktorë para dhe pas vjeljes janë gjithashtu çështje të rëndësishme, por sfiduese.

5.2. Zbulimi i çmimeve

Një vështirësi tjetër në vlerësimin e humbjeve dhe dizajnimin e produkteve të sigurimeve për pemët dhe perimet është zbulimi i çmimeve. Për shkak se kulturat nuk tregtohen hapur në një treg të mallrave, çmimet e tregut nuk është e lehtë të shihen. Për polisat e sigurimit të prodhimit, humbja e rendimentit kompensohet me një çmim të specifikuar shumëzuar me humbjen e rendimentit. Në SHBA, çmimi i përfshirë në polisa bazohet në çmimet në derë të fermës, të cilat përcaktohen nga Shërbimi i Marketingut Bujqësor i USDA. Përveç grupeve të tyre të të dhënave, ata përdorin të dhënat e raportuara mbi transaksionet dhe burimet private të të dhënave. Prodhuesit janë ankuar për çmimet jo të duhura pasi shumë prodhues mendojnë se çmimet janë shumë të ulëta për t'i kompensuar humbjet e shkaktuara nga humbjet e prodhimit. Në krahinën e Kolumbisë Britanike, çmimet zbulohen kryesisht përmes ekspertëve të tregut që punojnë me këtë industri. Zbulimi i çmimeve është i vështirë edhe për sigurimin e cilësisë, prodhuesit blejnë një vlerë në dollarë, që do të thotë se prodhuesit duhet t'i vlerësojnë nevojat e tyre sipas rrezikut të pritur të cilësisë dhe rrezikut të çmimeve.



Çmimi ka ndikim të madh në efektivitetin e sigurimeve. Ka sfida që lidhen me zbulimin e çmimeve edhe brenda llojit të mallrave. Për shembull, çmimet e mollës organike mund të mos ndjekin nga afër çmimet konvencionale të mollëve. Përmirësimet mund të bëhen për një masë më objektive dhe më transparente të zbulimit të çmimeve në SHBA dhe Kanada.

5.3. Korigjimi i humbjeve

Me rëndësi thelbësore për sigurimet është aftësia për t'i vlerësuar humbjet dhe për ta përcaktuar pagesën e dëmshpërblimit që prodhuesi duhet ta marrë. Është e domosdoshme që korigjimi i humbjeve të jetë i qartë dhe objektiv në mënyrë që në rast humbjeje, procesi i vlerësimit të fillojë në një mënyrë të përcaktuar në marrëveshjen ndërmjet siguruesit dhe të siguruarit.

Nën një polisë të sigurimit për një rrezik të caktuar, së pari kontrollohet nëse humbja e shkaktuar është e mbuluar me polisën e sigurimit. Shumë produkte të sigurimit të pemëve dhe perimeve janë me rrezik specifik, dhe jo për të gjitha rreziqet. Rreziku specifik i referohet situatës ku produkti i sigurimit mbulon vetëm një rrezik specifik, si shiu i tepërt, ose një sëmundje e caktuar, si p.sh miza e specave. Megjithatë, shpesh mund të jetë e vështirë të përcaktohet shkaku i humbjes, pasi faktikisht mund të ketë disa faktorë kontribuues për humbjen. Prandaj, nëse nuk është e mundur të konstatohet nëse humbja ishte shkaktuar nga një rrezik i siguruar, atëherë mund të mos jetë e mundur të sigurohet kombinimi kulturë/rrezik.

Më pas, humbja duhet të matet dhe dëmshpërblimi duhet të përcaktohet. Ky proces njihet si korigjim i humbjes. Në rastin e bujqësisë, humbja duhet të vlerësohet sipas faktorëve biologjikë. Me pemë dhe perime kjo mund të jetë veçanërisht sfiduese duke pasur parasysh se kulturat e ndryshme përgjigjen ndryshe ndaj rreziqeve të ndryshme dhe koha e ngjarjes mund të jetë e rëndësishme për sa i përket nivelit të humbjes. Për shembull, breshri është një rrezik kryesor i kushteve klimatike për rrushin, dhe breshri në pranverë mund të hedhë në tokë pjesët e frutave. Sidoqoftë, shpesh fruta të reja do të rriten nga sythat ekzistues, dhe kultura mund prapë të ketë rezultat. Edhe pse bima zakonisht do të japë rendiment në këtë skenar, shpesh ndodh që të ketë zvogëlim të sasisë dhe shpesh edhe cilësi më e ulët. Duke vazhduar me shembullin e rrushit, nëse breshëri e dëmton rrushin në verë, ekziston një probabilitet i lartë që e gjithë kultura do të shlyhet pasi ka gjasa që është tepër vonë për rritjen kompensuese. Prandaj, në rastin e sigurimit shpesh është e nevojshme që siguruesi të punojë me kultivuesin për të vendosur nëse është e mundur të shpëtohet diçka. Ndonjëherë shpëtimi i një kulture të dëmtuar do të thotë që është e mundur shitja e kulturës në një treg tjetër dhe jo atë të synuar fillimisht. Me rrushin e tryezës, nëse vërehet dëmtim në shpatullat e degëve të rrushit atëherë është e mundur që rrushi nuk do të gjejë treg. Megjithatë, te mollët e kultivuara për shitje të frutave me shumicë, pavarësisht nga dëmtimet nga breshri, mollët mund të gjejnë një treg për lëngje, për shembull.



6.0. Shqyrtim i përgjithshëm i llojeve të sigurimeve

Ka disa mënyra kryesore për t'i klasifikuar produktet e sigurimit të kulturave. Për shembull, polisat mund të ofrojnë mbrojtje për rendimentin ose për të ardhurat. Një mënyrë e dytë për grupimin e produkteve të sigurimit të kulturave bazohet në ofrimin e mbulimit për një mall të vetëm, ose përndryshe për disa mallra së bashku në një dizajn të sigurimit të fermës në tërësi. Produktet e sigurimit të kulturave bujqësore mund të klasifikohen edhe në bazë të dëmshpërblimit, që do të thotë që një korrigjues i humbjes e viziton një fermë individuale për ta vlerësuar humbjen, ose përndryshe në bazë të indeksit, që i referohet qasjes që automatikisht e përcakton humbjen e kulturës në bazë të një matjeje që është e pavarur dhe e verifikueshme, por ka korrelacion të lartë me humbjen. Në rastin e sigurimit në bazë të indeksit, produkti mund të dizajnohet për një individ të caktuar, ose, përndryshe, për një grup prodhuesish në një zonë (d.m.th në bazë të zonës). Secila prej tyre janë përshkruar shkurtimisht në vijim.

6.1. Të bazuara në rendiment

Planet e sigurimit të kulturave të bazuara në rendiment kanë për qëllim të sigurojnë mbulim për mungesat në prodhimin e rendimentit të kulturave. Kur prodhimi i vitit aktual është më pak sesa prodhimi mesatar afatgjatë (i përcaktuar si prodhim mesatar gjatë intervalit 5, 7, 10 vjeçar etj.), prodhuesi merr një pagesë. Rendimenti i siguar përcaktohet duke shumëzuar nivelin e zgjedhur të mbulimit (d.m.th 75%) nga rendimenti mesatar afatgjatë dhe nëse prodhimi i vitit aktual është nën këtë prag prodhuesi merr një pagesë në bazë të diferencës në prodhim shumëzuar me çmimin e tregut (që është vendosur në fillim të polisës). Prandaj planet e bazuara në rendiment japin mbulim vetëm për zvogëlimin e sasisë.

6.2. Të bazuara në të ardhura

Planet e sigurimit të kulturave të bazuara në të ardhura sigurojnë një nivel të synuar të të ardhurave bazuar në çmimet e tregut të kulturës së mbuluar dhe prodhimin mesatar afatgjatë. Ngjashëm me planin e sigurimit të bazuar në rendiment, prodhuesi merr mbrojtje nga prodhimi më i ulët, dhe përveç kësaj merr një pagesë për humbjen e vlerës së produkteve për shkak të rënies së çmimit. Me fjalë të tjera, dëmshpërblimet mund të jepen edhe kur rendimentet janë të larta, përderisa çmimet janë mjaft të ulëta. Nga ana tjetër, polisa mund të mos arrijë të japë dëmshpërblime me rendiment të ulët nëse çmimet janë mjaft të larta.

6.3. Mallrat individuale

Shumica e llojeve të produkteve të sigurimit mbulojnë një mall individual, i cili është i siguar në vete dhe i ndarë nga kulturat e tjera të kultivuara në fermë. Në këtë mënyrë, mbulimi i sigurimeve është i lidhur vetëm me humbjen e kulturës së caktuar, në vend të humbjeve totale në të gjitha mallrat në fermë. Kjo është shpesh qasje preferenciale për shumicën e prodhuesve pasi një humbje mund të ndodhë për një mall të caktuar dhe mund të merret një pagesë e dëmshpërblimit edhe në rastin kur nuk ka humbje (ose ka humbje të vogla) për kulturat e tjera. Për krahasim, siç diskutohet më poshtë, kur të gjitha mallrat janë të siguruara së bashku në një portfolio, ka kompensim të humbjeve ndërmjet tyre dhe është më e vështirë për një prodhues që ta marrë pagesën e dëmshpërblimit për një kulturë të caktuar, përveç nëse humbjet janë më të përhapura dhe ndikojnë në shumë kultura.



6.4. Ferma në tërësi

Ferma në tërësi i referohet situatës së diskutuar më lart, ku mbulimi jepet për të gjitha mallrat në fermë nën një polisë sigurimi. Poliset mund të bazohen në prodhim ose në të ardhura. Në teori, sigurimi i fermës në tërësi ka prime më të ulëta në krahasim me sigurimin për një mall individual pasi humbjet kompensohen ndërmjet vete (diversifikohen).

6.5. Të bazuara në dëmshpërblime

Tradicionalisht, produktet e sigurimit të kulturave kanë qenë polisa të bazuara në dëmshpërblime, të cilat i referohen situatës ku humbjet vlerësohen me matje fizike në nivel individual (të fermës). Poliset e bazuara në dëmshpërblim mund të vuajnë nga përzgjedhja e paqafavorshme (situata në të cilën i siguruari ka më shumë informacion për karakteristikat e humbjes së tij në krahasim me siguruesin) dhe/ose rreziku moral (situata ku i siguruari ndryshon sjelljen e vet pasi të sigurohet) dhe kjo mund të ketë si rezultat vendosjen e gabuar të çmimit. Një përparësi kryesore e produkteve të bazuara në dëmshpërblime është se ato e pasqyrojnë me saktësi situatën e dhënë në fermë.

6.6. Të bazuara në indeks

Në vend që të bazohet në një korigjues të humbjes për t'i matur humbjet dhe për ta llogaritur dëmshpërblimin, sigurimi i bazuar në indeks vlerëson humbjen bazuar në një indeks themelor që është në korrelacion të lartë me rendimentin në fermë. Në këtë mënyrë, mund të shmangët korigjimi i kushtueshëm i humbjes në fermë. Përparësitë kryesore të sigurimit të kulturave të bazuar në indeks janë eliminimi teorik i përzgjedhjes së paqafavorshme dhe rrezikut moral, si dhe ekonomizimi i fituar nga shmangia e korigjimit të humbjeve personalisht, si dhe efikasitetet e tjera administrative, siç është nënshkrimi i sigurimit. Mangësia kryesore e sigurimit të bazuar në indeks, megjithatë, është për shkak të rrezikut bazë, i cili është mospërputhja ndërmjet indeksit dhe humbjes aktuale të matur në terren.

Poliset e bazuara në indeks mund të dizajnohen për të mbuluar një prodhues individual, duke përfshirë shembujt ku stacionet e motit përdoren për ta parashikuar humbjen në një fermë individuale ose ku përdoren imazhe me rezolucion të lartë të marra nga distanca për ta siguruar fermën individuale. Përveç polisave individuale të sigurimit të bazuar në indeks, sigurimi sipas indeksit mund të mbulojë edhe një grup prodhuesish bazuar në një zonë të përcaktuar. Këto polisa të sigurimit të bazuara në zonë sigurojnë mbulim bazuar në një zonë të përbashkët dhe jo në nivel të fermerëve individualë. Për shembull, një prodhues mund ta marrë mbulimin e prodhimit për mungesën e rendimentit kur prodhimi i vitit aktual nuk e arrin rendimentin mesatar afatgjatë të qarkut (ose komunës). Mangësia kryesore e mbulimit me bazë në zonë është rreziku bazë, ku zona e përbashkët e qarkut mund të jetë e ndryshme nga ajo e fermës individuale.



7.0. Përvoja ndërkombëtare lidhur me mbulimin me sigurim për pemë dhe perime

Sektori i pemëve dhe perimeve është shumë i larmishëm dhe kjo krijon sfida në dizajnimin e një produkti të sigurimit që funksionon për të gjitha mallrat. Megjithatë, dizajnimi i polisave të veçanta të sigurimit për çdo mall individual ka gjasa të mos jetë realiste dhe kjo mund të çojë në konfuzion në mesin e prodhuesve dhe vështrësi me sigurimin dhe administrimin e numrit të madh të produkteve. Në këtë pjesë diskutohen disa lloje të produkteve të sigurimeve për pemë dhe perime, me theks në përvojën ndërkombëtare. Llojet e ndryshme të sigurimeve kategorizohen si sipas të ardhurave, marzhës, prodhimit dhe shtytësve të tjerë të specializuar. Brenda çdo kategorie të përgjithshme, diskutohen elementët specifikë të dizajnit të polisës, të cilat mund të jenë të bazuara në dëmshpërblim, në indeks, ferma në tërësi, mallra individuale shumë rreziqe, rrezik të caktuar, etj. Për të ndihmuar të ilustrohen llojet e ndryshme të produkteve të sigurimeve për pemët dhe perimet, disa shembuj të politikave specifike janë diskutuar bazuar në përvojën ndërkombëtare.

7.1. Të ardhurat

Sigurimi sipas të ardhurave jep mbrojtje kundrejt rënies së rendimentit, si dhe kundër uljes së çmimit. Produktet sipas të ardhurave mund të bazohen në indeks ose mund të jenë të bazuara në dëmshpërblim dhe një dimension tjetër është nëse produkti është për një mall individual ose për fermën në tërësi.

Shtetet e Bashkuara

RMA e USDA ka bërë angazhime të rëndësishme në zhvillimin e metodave të sigurimit dhe menaxhimit të rrezikut për sektorin e pemëve dhe perimeve. Ky program bazohet kryesisht në mbulimin e të ardhurave. Dy planet kryesore të bazuara në të ardhura që janë në dispozicion për kultivuesit e pemëve dhe perimeve janë Historia e Ardhurave Aktuale (ARH) dhe Programi i të Ardhurave të Fermës në Tërësi (WFR). Secili prej tyre është diskutuar më poshtë.

Historia e të Ardhurave Aktuale (ARH): Plani ARH është në dispozicion për qershi, portokaj dhe dredhëza, në qarqet dhe shtetet e përzgjedhura, dhe bazohet në informacionin e të ardhurave historike të prodhuesit në bazë të kulturës individuale. Ky plan është shumë i ngjashëm me programin e Historisë së Prodhimit Aktual (APH) në SHBA, që është përshkruar më poshtë, megjithatë, në vend që të sigurohen rendimentet historike, sigurohen të ardhurat historike. Prandaj, programi ofron mbrojtje kundër rendimenteve të ulëta, çmimeve të ulëta, cilësisë së ulët, ose ndonjë kombinimi. Mbulimi është për historinë e të ardhurave neto të një prodhuesi individual, që përcaktohet pas vjeljes në pikën e dorëzimit të parë dhe përfshin 4 deri në 10 vjet të të dhënave të të ardhurave. Në përgjithësi, nivelet e mbulimit janë ndërmjet 50 dhe 85 për qind të të ardhurave të aprovuara. Raportet e të ardhurave përbajnë informacione mbi shumat e sigurueshme të sipërfaqes, prodhimin, vlerësimin e prodhimit dhe të ardhurat, dhe të gjitha të dhënat duhet të jenë të garantuara me regjistra të verifikueshëm, që përfshin regjistrat e humbjeve të mbajtura nga Ofruesit e Sigurimeve të Aprovuara (AIP), fletët e pagesave ose vlerësimet. Në rastin e sipërfaqes së marketingut të drejtpërdrejtë, vlerësimet janë të nevojshme dhe duhet të shoqërohen me të dhënat e shitjeve. Përcaktimi vjetor i të ardhurave gjithashtu përfshin prodhimin e pavjelur të tregtueshëm. Në rastet kur kultivuesit nuk kanë çmim vjetor nga shitjet aktuale për t'u përdorur për vlerësimin e prodhimit të pavjelur të tregtueshëm, përdoret çmimi NASS.

Të Ardhurat e Fermës në Tërësi (WFR): Në vitin 2016, RMA lansoi sigurimin e mbrojtjes së të ardhurave të fermës në tërësi (WFRP) për të gjitha qarqet në vend. Qëllimi ishte të synohen prodhuesit të cilët më parë kishin pasur qasje të kufizuar në menaxhimin e rrezikut dhe alternativat e sigurimeve. Politika WFRP jep nivel më të lartë të subvencioneve të primit mbi llojet e tjera të polisave dhe siguron 50% deri në 85% të të ardhurave për të gjitha mallrat në fermë së bashku në një polisë sigurimi, në vend që të kërkohet sigurim për mallrat individuale. Mbulimi jepet për çdo fermë deri në 8.5 milion dollarë në të ardhura të siguruara, duke përfshirë fermat e specializuara



ose mallrat organike. Të dhënat nga deklaratat tatimore përdoren për ta përcaktuar garancinë historike të të ardhurave dhe të ardhurat për vitin e kulturës së siguruar.

Pritja e WFRP është të inkurajojë më shumë diversitet të kulturave në ferma dhe polisa e sigurimit jep një zbritje të primit ndërsa sigurohen më shumë kultura me atë polisë për të pasqyruar diversifikimin e shtuar (rrezik më i ulët për shkak të kompensimit të rreziqeve). Natyra e polisës për fermën në tërësi synon gjithashtu të ndihmojë në përkrahjen e prodhimit të një shumëllojshmërie ushqimesh. Produkti i sigurimit WFRP është dizajnuar edhe me fleksibilitet në mendje për të ofruar një gamë të niveleve të mbulimit, mbulimin për ri-mbjellje, mbulimin për zgjerimin e operacioneve, shumë maksimale më të lartë të mbulimit dhe përfshirjen e kostove të gatishmërisë së tregut në mbulim. Në vitin 2017 u vlerësua se 2,700 polisa u shitën me detyrime prej 2.8 miliardë dollarësh, që ishte një rritje prej 1,100 të shitura në vitin 2015 me detyrime prej 1.1 miliardë dollarësh. Prodhuesit marrin një normë subvencioni prej 80% të paguar nga qeveria federale, që krahasohet me një subvencion mesatar të primit prej rreth 62% për sigurimet e të gjitha kulturave.

Disa sfida janë hasur në lidhje me polisën e sigurimit të WFRP. Për shembull, përdorimi i të dhënave tatimore si bazë për përcaktimin e mbulimit dhe pagesave ka shkakuar disa sfida administrative. Për shembull, mund të ketë dallime ndërmjet kërkesave të kontabilitetit tatimor dhe të sigurimeve dhe vështirësitë me WFRP lidhur me dokumentacionin dhe sfidat e verifikimit, shpejtësinë e pagesave të sigurimeve dhe korigjimet e madhësisë së fermës ose përbërjes së mallrave që mund të ndryshojnë nga viti në vit. Për ndërmarrjet e mëdha që prodhojnë pemë dhe perime me vlerë të lartë, ka pasur kritika edhe për kufirin prej 8.5 milion dollarë për vlerën e siguruar.

Disa përmirësime të sugjeruara për WFRP përfshijnë aftësinë që prodhuesit t'i përdorin çmimet e kontratës ose indekset e çmimeve për vlerësimin e kulturave, në vend që t'i dorëzojnë regjistrat tatimorë. Përderisa disa kontrata të ardhme që tregtohen në bursë nuk ekzistojnë për disa tregje, gjetja e një indeksi të çmimeve që konsiderohet i pavarur dhe i verifikueshëm kërkon të dhëna nga burime të tjera përveç tregjeve të mallrave. Shërbimi Kombëtar Statistikor i Bujqësisë dhe Shërbimi i Marketingut Bujqësor mbledhin të dhëna kombëtare dhe rajonale për çmimet e pemëve dhe perimeve, duke përfshirë disa për pemë dhe perime organike. Derisa në rastin e përdorimit të çmimeve të kontratës ose të indekseve të çmimeve, rendimentet prapë duhet të raportohen për t'i krijuar të ardhurat, ky ndryshim mund të ndihmojë në trajtimin e disa çështjeve rreth shpejtësisë së pagesave dhe përfaqësimit të çmimeve. Kjo, megjithatë, do të krijonte probleme rreth rrezikut moral pasi fermerët potencialisht do të ishin në gjendje ta rrisin prodhimin e kulturave për të cilat nuk ka kërkesë për të marrë një pagesë sigurimi për prodhimin e mbetur pa u shitur.

7.2. Marzha

Ngjashëm me konceptin e sigurimit të të ardhurave të përkrahur më lart, sigurimi i marzhës është një lloj tjetër alternativ i dizajnit të produkteve të sigurimit. Marzha është diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të një prodhuesi (d.m.th hyrje-dalje). Si më lart, sigurimi i marzhës në teori mund të dizajnohet për një mall individual ose të bazuar në fermën në tërësi. Po ashtu, sigurimi i marzhës mund të jetë i bazuar në dëmshpërbim ose në bazë të indeksit.

Kanada

Programi kryesor i Kanadasë për Menaxhimin e Rrezikut të Biznesit është quajtur AgriStability dhe përfshin mbrojtjen për fermat e pemëve dhe perimeve.

AgriStability mbulon marzhën e prodhuesit për tërë fermën (dhe jo një mall individual). Nëse marzha e një prodhuesi bie nën 70% të marzhës mesatare 5-vjeçare olimpike, AgriStability paguan 70% të marzhës. Prandaj, AgriStability mbulon kushtet e pafavorshme të tregut, duke përfshirë humbjet e prodhimit (në mënyrë indirekte duke përfshirë disa rreziqe të lidhura me cilësinë dhe sëmundjet) ose rritjen e kostos së prodhimit. Për të aplikuar për AgriStability, prodhuesit duhet të paraqesin informacionin e tyre mbi të ardhurat dhe shpenzimet (tatimet) në formularin T1163 në Agjencinë e të Ardhurave të Kanadasë dhe ky informacion pastaj i jepet organizatës së sigurimit të kulturave të qeverisë provinciale.





Nëpërmjet formularit T1164 ofrohet edhe informacion shtesë, i cili jep informata mbi inventarët, llogaritë e arkëtueshme, të pagueshmet, shtyrjet dhe faktorët e blerë. Duke pasur parasysh se programi punon në bazë të një marzhe referente, kërkohet të paktën pesë vjet të të dhënave historike. Tarifa për pjesëmarrje përfshin një tarifë prej 55 dollarësh, si dhe një tarifë që është afërsisht \$315 për \$100,000 të marzhës referencë. Në Kanada, megjithatë, aktualisht është në proces një rishikim i AgriStability, pasi shumë prodhues kanë treguar se e kanë humbur besimin në këtë program për shkak të mungesës së transparencës dhe parashikueshmërisë, shpejtësisë së pagesave, kompleksitetit, mungesës së njohjes për fermerat shumë të diversifikuara dhe nivelet e kufizuara të mbulimit, ndër arsytet e tjera.

7.3. Bazuar në rendiment (bazuar në prodhim)

Një rishikim i përvojës ndërkombëtare sugjeron që planet e bazuara në rendiment duket të jenë më të përhapura për sigurimin e pemëve dhe perimeve, me përjashtim të SHBA-së, ku planet e bazuara në të ardhura janë mbizotëruese. Në përgjithësi, polisat e bazuara në rendiment janë ose 1) për shumë rreziqe dhe zakonisht mbulojnë të gjitha rreziqet natyrore duke përfshirë kushtet atmosferike, zjarrin, insektet, sëmundjet, kafshët e egra etj., Ose 2) vetëm për një rrezik dhe mbulojnë një rrezik të caktuar, si acari, ose breshri, ose një sëmundje specifike, si shembuj. Disa shembuj të bazuar në përvojën ndërkombëtare janë dhënë më poshtë. Shembujt e parë janë për polisat e llojit të shumë rreziqeve, ndërsa grupi i dytë i shembujve janë për politikat me rrezik të përcaktuar.

7.3.1. Shumë rreziqe

Kanada

Në Kanada ekzistojnë disa shembuj të planeve të bazuara në rendiment për pemët dhe perimet. Së pari, është dhënë një diskutim për programet e sigurimit të perimeve në bazë të rendimentit për krahinat Saskatchewan, Manitoba dhe Ontario. Mandej, është dhënë një diskutim për sigurimin e pemëve në provincën e Ontarios.

Sigurimi i perimeve në Saskatchewan dhe Manitoba

Në provincat Saskatchewan dhe Manitoba, sigurimi i humbjes së sipërfaqes së perimeve është dhënë për kultivuesit e perimeve komerciale. Polisa mbulon humbjen e prodhimit (rendiment më i ulët) për shkak të rreziqeve natyrore. Prodhuesit e perimeve i sigurojnë tokat e tyre në vlerën bazë për akër (njësi e sipërfaqes), minus një 10% të zbritshme në rast të ankesës. Në rast të humbjes së hershme, një dëmshpërblim prej 25% të mbulimit zbatohet për kulturat e shkatërruara (deri në fund të afatit të mbulimit të zgjeruar të mbjelljes direkte). Sapo të kalojë faza e hershme e humbjes, zbatohet një zbritje prej 10% të sipërfaqes totale të siguruar të mbjellë. Dëmshpërblimi për humbjen ose dëmtimin e kulturave të perimeve që i plotësojnë kushtet llogaritet si:

(Akra të shkatërruara - Zbritja) x mbulimi për akër,

ku zbritja është 10% e sipërfaqes totale të siguruar të kulturave të perimeve të prekura të cilat kualifikohen.

Kulturat e perimeve që kualifikohen përfshijnë: brokoli, lakër, lulelakër, karrotë, pastinak, rutabagas, misër i ëmbël, qepë gatimi, qepë të tjera, purri, specia, kunguj dhe kunguj dimëror. Shumica e kulturave kanë një vlerë bazë prej \$2500/ akër, me përjashtim të bizeleve, fasuleve dhe misrit të ëmbël, të cilat kanë vlerë bazë prej \$950/akër. Kriteret e tjera për mbulimin e sigurimeve janë që perimet duhet të ujitën, një minimum prej tre akra të mbjella me një kulturë që kualifikohet dhe qiradhënësit nuk kualifikohen. Në rast të një kërkesë akra e prekur duhet të jetë në blloqe prej ½ akre ose më shumë, dhe kultura e prekur nuk



mund të shkatërrohet derisa të inspektohet nga kompania e sigurimeve. Pasi që kultura të jetë inspektuar, nëse rendimenti potencial është nën një sasi të paracaktuar, prodhuesi mund ta shpëtojë atë rendiment dhe akoma të jetë i kualifikuar për dëmshpërblim të plotë të Humbjeve në sipërfaqe të perimeve.

Sigurimi i perimeve në Ontario

Ngjashëm, në provincën e Ontarios ekzistojnë dy lloje kryesore të planeve të sigurimit për kultivuesit e perimeve që japin pagesë dëmshpërblimi kur një rrezik i siguruar (kushtet e këqija klimatike, kafshët e egra, infektimi me insekte dhe sëmundjet) shkakton të ulët rendimenti nën prodhimin e garantuar. Dy llojet e planeve janë mbulimi i bazuar në rendiment dhe mbulimi i humbjes në sipërfaqe. Mbulimi i bazuar në rendiment jep një pagesë të dëmshpërblimit kur një rrezik i siguruar shkakton që rendimenti të bjerë nën prodhimin e garantuar në të gjitha aktrat. Mbulimi me humbje të sipërfaqes në anën tjetër jep pagesë dëmshpërblimi kur një rrezik i siguruar shkakton ulje të mëdha të rendimentit që shkaktojnë që rendimenti të bie nën një prag të paracaktuar të braktisjes. Këto pragje bazohen në prodhimin e paracaktuar të kulturës që pritet të kërkohet për t'i mbuluar kostot e prodhimit. Për të dyja planet, mbulimi është i kufizuar në fushë dhe nuk përfshin sëmundjet pas vjeljes të shfaqura gjatë ruajtjes në depo. Çmimet e kërkesave përcaktohen në bazë të çmimeve mesatare të marra nga një shumëllojshmëri burimesh varësisht nga malli, siç janë anketat e paketuesve, anketat e qeverisë provinciale dhe çmimet mesatare të industrisë. Ashtu si në Alberta dhe Manitoba, ka edhe një përfitim të mbetur, i cili kompenson kultivuesit për paga dhe kostot e fuqisë punëtore që lidhen me to, plus 30% deri në maksimum prej 435\$/akër, ku vlera e çdo kërkesë të shpëtimit dhe prodhimit nuk mund ta tejkalojë përgjegjësinë totale për kontratë.

Sigurimi i perimeve në Kolumbinë Britanike

Në Kolumbinë Britanike, ekzistojnë dy opsione për sigurimin e perimeve, që përfshijnë mbulimin e sasisë dhe sipërfaqes. Mbulimi i sasisë është sigurimi i individualizuar i perimeve që jep mbrojtje më të madhe për humbje të mëdha, mbulim të përshtatur dhe mbulim kundër rendimentit të ulët. Nuk ofrohet për sallatë, brokoli të freskëta të tregut dhe produkte të tjera të freskëta të tregut. Mbulimi i cilësisë ofrohet për perimet për përpunim. Mbulimi me humbje të sipërfaqes krahason humbjet e fermës kundrejt pragjeve të paracaktuara të braktisjes. Pragjet bazohen në rendimentin e kulturës të nevojshëm për të përmbushur kërkesat e kostos së prodhimit. Është dizajnuar për produkte të freskëta të tregut dhe jep pagesë më të shpejtë për humbjet e sezonit të hershëm dhe nuk varet nga të dhënat historike të prodhimit.

Sigurimi i pemëve në Ontario

Sigurimi i bazuar në prodhimin është në dispozicion edhe për pemët në Kanada. Për shembull, në Ontario mbulimi i sigurimeve ofrohet për mollë dhe pemë të mollës, rrush dhe hardhi rrushi, pjeshkë dhe nektarina, dardha, kumbulla dhe qersh dhe vishnje.

Mbulimi i sigurimit të prodhimit funksionon ngjashëm me atë që u përshkrua më sipër për perimet. Për ta përcaktuar mbulueshmërinë, secili prodhues e llogarit rendimentin përfundimtar mesatar (FAY), dhe kjo përdoret si një referencë për ta përcaktuar nëse prodhimi i vitit aktual është nën mesataren. FAY llogaritet në bazë të një periudhe 5-vjeçare për pjeshkë dhe nektarina, 6 vjet për mollë, dardhë, kumbulla, qersh dhe vishnje, dhe 5-10 vjet për rrush. Për pjesëmarrësit e rinj çdo kulture i është caktuar një FAY pesë ose gjashtëvjeçar, i bazuar në faktorë të tillë si lokacioni, mosha dhe shëndeti i pemës, lloji i tokës etj. Përveç kësaj, korrigjimet e rendimentit mund të bëhen për ta rritur FAY për të pasqyruar rritje të parashikuara në aftësinë e prodhimit për fidanët e rinj, dhe për ta ulur FAY për të pasqyruar uljen e aftësive prodhuese të nevojshme për shkak të Heqjes së pemëve ose hardhive. Korrigjimi i rendimentit përdoret gjithashtu për të ndihmuar stabilizimin e mbulimit në rastin e një viti të keq. Në këtë rast, rendimentet jashtëzakonisht të larta dhe të ulëta korrigjohen për ta stabilizuar dhe ulur ndikimin e rendimenteve ekstreme në FAY. Korrigjimi zbatohet pas çdo korrigjimi të rendimentit. Pragu për korrigjim është vendosur duke

u bazuar në vendosjen e një pragu të epërm (të poshtëm), që është 130 (70) përqind i rendimentit mesatar të hapjes dhe i korrigjuar për 2/3 poshtë (lart) deri në pragun e epërm. Pastaj, rendimentet e korrigjuara përdoren për ta vendosur rendimentin e ri mesatar të korrigjuar. Rendimentet mbledhen ose në vjelje nga një korrigjues në qoftë se ka dëmtim të kulturës, përndryshe një korrigjues e viziton fermën para datës 1 Maj çdo vit për të mbledhur rendimentet për vitin e kaluar (është e rëndësishme që të mbahen të dhënat e sakta të rendimentit).

Për disa kultura të pemëve lejohen korrigjimet e shpërndarjes. Për shembull, për mollët një prodhues mund ta ndajë FAY-in e tyre për kulturat e freskëta dhe kulturat për lëng. Korrigjimi i shpërndarjes së përqindjes së mollëve të freskëta ndihmon në stabilizimin e shpërndarjes së mollëve të freskëta dhe ato për lëngje nga viti në vit për ta zvogëluar ndikimin e rendimenteve shumë të ulëta ose të larta në FAY. Përveç mbulimit themelor, kultivuesit e pemëve në Ontario mund ta zgjedhin edhe një mbulim të zgjeruar bazë të breshërit që jep një përfitim të shlyerjes dhe shpëtimit, si dhe shtesa për drurët e pemëve. Shtesa e breshërit dhe mbulimi bazë i zgjeruar janë diskutuar në pjesën e mëposhtme në mbulimin e breshërit dhe shtesa e drurëve të pemës përshkruhet më poshtë në pjesën mbi sigurimin e pemëve, shkurreve dhe hardhive.

Kina

Në Kinë, mallrat bazë të siguruara për sigurimin e pemëve dhe perimeve përfshijnë mollë, banane, dardha, qersh, agrume, shalqi, rrush, perime të fushës, të tilla si domate dhe kastravec, dhe perime të freskëta të serrave. Sigurimi jep mbulimin për humbjen e rendimentit për shkak të breshërit, erës për "nivelin 6", rrëshqitjeve të tokës, thatësirave të rënda, dëmtuesve dhe acarit. Detyrimet specifike dhe normat e primit ndryshojnë sipas mallrave dhe provincës. Në përgjithësi, dëmshpërblimi është i barabartë me detyrimin për Mu (ekuivalent me 666 metra katror tokë), shumëzuar me raportin e humbjeve dhe madhësinë e zonës së prekur. Raporti i humbjes është i barabartë me numrin e pemëve të humbura për Mu pjesëtuar me numrin e pemëve për Mu në vitet normale. Pemë e humbur do të thotë pemët që bien nga druri ose pemët e dëmtuara nga rreziku i caktuar. Numri i pemëve për Mu në vite normale vendoset sipas përvojës së ekspertëve. Në rastin e mollëve Fuji, është 10,000 për Mu dhe për mollë Gala është 15,000 për Mu, si shembuj.

Japoni

Në Japoni, ka shembuj të mbulimit mjaft të plotë për pemë, drurë të pemëve dhe hardhi. Poliset mbulojnë rënien e rendimentit, dhe në disa raste gjithashtu mbulojnë përkeqësimin e cilësisë për shkak të rrezikut të përcaktuar. Fermerët mund t'i sigurojnë rendimentet edhe kundër një rreziku të vetëm. Gjithashtu, fermerët mund të zgjedhin ta sigurojnë rendimentin për të gjithë fermën ose në bazë të pjesës së tokës.

Shtetet e Bashkuara

Prodhimi i bazuar në rendiment për pemë dhe perime në SHBA është paraparë në planin e Historisë së Prodhimit Aktual (APH). APH jep mbulim nga humbja e prodhimit dhe garanton rendimentin bazuar në historinë e prodhimit të prodhuesit. Nëse prodhimi është më i vogël se shumica e garantuar, paguhet një dëmshpërblim. SHBA gjithashtu ka plane të bazuara në rendiment të quajtura Mbrojtja e Rendimentit (YP), megjithatë, në rastin e pemëve dhe perimeve APH është politika e përdorur sepse çmimet sipas këtij plani përcaktohen nga RMA, ndërkohë që politikat e YP kanë çmime të përcaktuara përmes dispozitës së këmbimit të mallrave. Në rastin e mollëve, plani APH është plani i vetëm i sigurimit në dispozicion. Rendimenti i APH bazohet në deri në 10 vjet të rendimenteve aktuale dhe/ose rendimenteve të caktuara. Nivelet e mbulimit janë ndërmjet 50 dhe 75%, dhe primi i subvencionuar ndryshon varësisht nga niveli i mbulimit dhe nëse prodhuesi siguron njësitë bazë (BU) ose njësitë opsionale (OU). Njësitë bazë përfshijnë të gjithë sipërfaqen e mollëve të sigurueshme në qark sipas marrëveshjes dhe llojit të ndarjes, ndërsa njësitë opsionale përbëhen nga dy ose më shumë pjesë të tokës. Zgjedhjet e çmimeve përcaktohen nga RMA në njësi për shinik (bushel-njësi matëse e peshës), me kategori përfshirë të freskëta, të , varieteti i grupit A (të freskëta), Varieteti i grupit B (të freskëta) dhe varieteti i grupit C (të freskëta).

Plani gjithashtu përfshin mbulim opsional për korrigjimin e cilësisë, ku opsioni të freskëta zbatohet për mollë të freskëta të dëmtuara deri në masën që 20 përqind



ose më shumë prej mollëve nuk klasifikohen si të mira në Shtetet e Bashkuara ose më mirë.

Mbulesa e breshërit është në dispozicion në shumë raste ndërkombëtare. Për shkak të faktit se breshëri është rreziku kryesor lidhur me klimën në rritjen e pemëve (pasuar nga ngrica dhe thatësira) mbulimi nga breshri ofrohet kryesisht për kulturat e pemëve. Politikat që mbrojnë veçanërisht për acar janë gjithashtu në dispozicion në disa juridiksione. Perimet në anën tjetër kanë tendencë të ndikohen më shumë nga reshjet e tepërta dhe thatësitat, dhe acari dhe breshëri janë problematike në një masë më të vogël. Këto lloje të rreziqeve specifike varen shumë nga rrethanat rajonale dhe lokale.

Ontario, Kanada

Për disa lloje të kulturave të pemëve në Ontario, shtesa për breshër mund të blihet përveç mbulimit bazë për të ofruar mbrojtje shtesë, dhe me këtë përfitim prodhuesi merr mbrojtje të veçantë të pemëve kundër një zvogëlimi të cilësisë së pemëve për shkak të dëmtimit nga breshëri. Për kërkesë për shtesën e breshërit për mollë, si shembull, një pemishte e vetme duhet të vuajë një minimum prej 10 për qind të dëmit nga breshëri. Dëmtimi duhet të raportohet tek organizata e sigurimit të kulturave menjëherë pasi ndodh rreziku. Korrigjuesi mund ta vizitojë fermë për ta parë dëmin. Pas heqjes së pemëve me dorë para vjeljes dhe sa më afër vjeljes që të jetë e mundur, bëhet numërimi aktual i breshërit duke përdorur standardet e gradimit. Kjo është për shkak se numërimi i breshërit ka për qëllim ta vlerësojë dëmtimin nga breshëri të pemëve që duhet të vilen. Procedura e numërimit të breshërit përdoret për t'i klasifikuar pemët, dhe përcaktimet për të freskëta/lëng ose të freskëta/përpunimi bëhen duke përdorur Rregulloret e pemëve dhe perimeve të freskëta sipas Aktit të Produkteve Bujqësore të Kanadasë. Për mollët, si shembull, ato përcaktohen për lëng nëse dëmtimi nga breshëri shkakton lëkurë të prishur, njolla, shenjat individuale të breshërit që tejkalojnë 1/8 inç në diametër dhe sipërfaqja totale me shenja kalon ¼ e një inç në diametër. Kërkesa për shtesë të breshërit mund të paguhet edhe nëse rendimenti total është mbi nivelin e garantuar.

Prodhuesit gjithashtu mund të zgjedhin një mbulim bazë të rritur, i cili jep përparësinë e shtuar të përfitimit të shlyerjes dhe rikuperimit. Për shembull, ndonjëherë dëmi nga breshëri mund të jetë mjaft i madh që nuk ia vlen të vilen frutat e freskëta. Nëse dëmi nga breshëri tejkalon vlerën e provizionit të shlyerjes prej 70 për qind, prodhuesit nuk janë të detyruar t'i vjelin pemët e padëmtuara si klasa të freskëta, dhe në vend të kësaj mund t'i vjelin për tregun e lëngjeve.

Zelanda e Re

Në Zelandën e Re, sigurimi i prodhimit ofrohet për një shumëllojshmëri të pemëve dhe perimeve. Përveç kësaj, ka mbulim opsional sigurimi për pemët që përfshin një mbulim të humbjes nga acari. Kjo mbron nga humbja e pemëve që janë duke u rritur për shkak të dështimit të pajisjeve të mbrojtjes nga ngrirja nëse ka prishje mekanike ose elektrike. Pemët e vjelura gjithashtu mund të mbulohen për humbje të papritur dhe të paparashikuar deri në 30 ditë nga data e vjeljes, duke përfshirë kur janë në transit (deri në 300 km). Opsionet e tjera të mbulimit përfshijnë humbjen totale konstruktive, e cila jep një pagesë të shumës totale të siguruar kur pemishtja është dëmtuar më shumë se 65% dhe nuk është ekonomike të vilet. Kostot plotësuese të lidhura me një humbje mund të ofrohen gjithashtu, të cilat mund të lidhen me pastrimin e dëmeve, ose largimin kimik ose manual të pemëve të dëmtuara dhe/ose asgjësimin e pemëve të dëmtuara.

Zelanda e Re ka edhe një grup shumë interesant për sigurimin nga breshëri për kivi, të quajtur Politika e Sigurimit të Grupit të Kufizuar Zespri. Polisa paguan humbje nëse pema kivi është dëmtuar për shkak se është goditur drejtpërdrejt nga breshri, në hardhi dhe nuk është në gjendje t'i përmbushë standardet e eksportit si rezultat i këtij dëmtimi. Ky grup ofron mbulesë për gjithsej 6 milionë dollarë. Zbritja është zakonisht 10% nëse është kërkesa e parë dhe kërkesat e mëvonshme rriten për nga 5% çdo herë. Nëse ndodh breshëri, prodhuesi duhet të kontaktojë me kompaninë e sigurimit dhe ta japë emrin, vendndodhjen, të dhënat dhe ngjarjen kohore të ndodhur, dhe përqindjen e vlerësuar të pemëve të dëmtuara.



7.4. Sigurimi i ri-mbjelljes së drurëve, shkurreve dhe hardhive

Në disa juridiksione, prodhuesit mund të blejnë edhe sigurimin për prishjen e pemëve, shkurreve apo hardhive. Disa shembuj janë diskutuar më poshtë.

Shtetet e Bashkuara

Në Shtetet e Bashkuara, Programi i Ndhmës së Drurëve (TAP) mbulon prodhuesit e kualifikuar të pemishteve dhe kultivuesit e pemëve për ri-mbjelljen ose rehabilitimin e pemëve, shkurreve dhe hardhive të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore. Në Japoni, sigurimi i drurëve dhe hardhisë mbulon tharjen e bimës ose dëmtimin e rëndë nëse pemët thahen, barten nga shiu, zhduken ose groposen.

Ontario, Kanada

Në provincën e Ontarios, Kanada, ekziston një opsion standard i mbulimit të pemëve për kultivuesit e pemëve, ku primet subvencionohen plotësisht nga qeveria me një zbritje të përcaktuar. Mbulimi shtesë është gjithashtu i mundshëm për një prim, i cili zvogëlon zbritjen. Ky mbulim jep mbrojtje shtesë nëse pema thahet si rezultat i rreziqeve të caktuara. Një pemë ose hardhi konsiderohet e tharë kur nuk ka mundësi për ta rikthyer drurin ose hardhinë si njësi të prodhimit të qëndrueshëm. Pas njoftimit të kompanisë për sigurimin e kulturës për dëmin, një korrigjues e kontrollon për të siguruar që humbja është shkaktuar nga një rrezik i siguruar, janë zbatuar praktikatat e mira të menaxhimit të fermës dhe mund ta aprovojë heqjen e drunjve ose hardhive. Dy shembuj janë dhënë për të ilustruar detajet që rrethojnë shtesën e pemëve, duke përfshirë për mollët dhe rrushin.

Molla: kërkesa paguhet sipas shtesës nëse:

- Rreziqet natyrore, duke përfshirë lagështinë e tepërt, erën e tepërt, zjarrin, ngrirjen, acarin, ose breshërin.
- numri i pemëve që janë tharë nga një rrezik i siguruar është më i madh ose i barabartë me zbritjen prej 7.5 për qind të vlerës së garantuar.
- Praktikatat e mira të menaxhimit të fermave janë respektuar.
- Një numër i madh i prodhuesve që kultivojnë të njëjtat varietete të vendosura brenda një rrezeje prej 7.5 km të pemëve të thara, gjithashtu vuajnë nga pemët e thara në të njëjtën kohë për shkak të rrezikut të njëjtë të siguruar, ose pemët janë tharë për një varietet që është kultivuar me rrënjë të vërtetuar brenda një rrezeje prej 7.5 km nga ku pemët janë të vendosura për një minimum prej 10 vjetësh, për të cilat rreziku mund të verifikohet në mënyrë të pavarur.

Rrush: kërkesa paguhet sipas shtesës nëse:

- Rreziqet natyrore, duke përfshirë mos-lulëzimin, thatësinë, nxehësinë e tepruar, lagështinë e tepërt, reshje të tepërta, ngrirje, erë e tepruar, breshër, përmbytje.
- numri i pemëve që janë tharë nga një rrezik i siguruar është më i madh ose i barabartë me zbritjen prej 12.5 për qind të vlerës së garantuar.
- Praktikatat e mira të menaxhimit të fermave janë respektuar.
- Një numër i madh i prodhuesve që kultivojnë të njëjtat varietete të vendosura brenda një rrezeje prej 1 km të pemëve të thara gjithashtu vuajnë nga tharja e pemëve në të njëjtën kohë për shkak të rrezikut të njëjtë të siguruar, ose tharja e pemëve ka ndodhur për një varietet që është kultivuar me rrënjë të vërtetuar brenda të njëjtës zonë klimatike nga ku pemët janë të vendosura për një minimum prej 10 vjetësh, për të cilat rreziku mund të verifikohet në mënyrë të pavarur.



Kolumbia Britanike, Kanada

Ngjashëm, në Kolumbinë Britanike, për mollë, kajsji, pjeshkë, dardhë, kumbulla dhe qershi, ekziston një polisë e mbulimit të drurëve të pemëve që mbulon rreziqe të tilla si thatësira, ngrirja, rrëshqitja e tokës, lagështia e tepërt, zjarri, era, akulli dhe bora, sëmundjet e pemës dhe sëmundjet virale për të cilat nuk ka metoda të njohura të kontrollit. Kjo polisë mbulon drurët e pemëve të paaftë për të prodhuar të paktën 60% të rendimentit të vitit të mëparshëm të kultivimit. Përveç kësaj, ka mbulim të hardhisë së rrushit për humbjen e hardhisë së rrushit për shkak të thatësirës, ngrirjes, rrëshqitjes së dheut dhe zjarrit. Për dredhëzat rreziqet përfshijnë lagështi të tepërt, ngrirjen dhe rrëshqitjen e dheut. Në fund, boronica ka një mundësi mbulimi kundër ngrirjes, zjarrit, rrëshqitjes së dheut, lagështisë së tepërt, breshërit, erës, akullit dhe borës, nxehësive ekstreme dhe thatësirës së shkaktuar nga humbja e furnizimit me ujë për ujitje. Ka mbulim të shumëfishtë dhe opsione të zbritjes me çmime të ndryshme.

Izraeli

Në Izrael, fondi i sigurimeve për fatkeqësitë natyrore quhet Kanat. Programi kryesor siguron mbulimin nga shumë rreziqe për humbjet e lidhura me prodhimin, kryesisht për drurët e pemëve. Në rast se drunjat janë dëmtuar, kostot e ripërtërirjes gjithashtu mbulohen.

7.4.1. Programe të tjera

NAP e SHBA

Në SHBA, kur sigurimi federal i kulturave nuk është në dispozicion për disa kultura të specializuara, Programi i Ndhmës për Kulturën e Pasiguruara në Fatkeqësi (NAP) u jep prodhuesve ndihmë financiare kur rendimentet janë të ulëta, ka humbje të inventarit dhe mbjellja është penguar për shkak të fatkeqësive natyrore. Aktualisht kulturat e specializuara që kualifikohen për NAP janë për kërpudhat, lulet, bimët dekorative, pemët e Krishtlindjeve, barin artificial dhe zhenshenin.

Ontario, Kanada

Në Kanadë në provincën e Ontarios ekziston edhe një program i quajtur plani i vetë-drejtuar i menaxhimit të rrezikut (SDRM) për hortikulturë ushqimore, që jep mbrojtje për humbjet e përgjithshme të fermës ose shpenzimet. Prodhuesit në këtë provincë mund të depozitojnë një përqindje të shitjeve të tyre të lejuara neto në një llogari të SDRM, dhe qeveria e provincës kontribuon në atë llogari. Programi ka për qëllim të sigurojë fleksibilitet, duke i lejuar prodhuesit të tërheqë fonde për të mbuluar të ardhurat e ulëta, investimet në mjetet e menaxhimit të rrezikut, ose shpenzime apo humbje të tjera që lidhen me biznesin e tyre në fermë.

7.5. Mbulueshmëria specifike kundër sëmundjeve

Ontario - Qasja LQM

Në Ontario, një studim i fizibilitetit është kryer kohët e fundit për ta shqyrtuar mundësinë e një modeli të matjes së humbjes (LQM) për të trajtuar një sëmundje specifike me të cilën ballafaqohen kultivuesit e specit, të quajtur miza e specit. LQM është një qasje e strukturuar e përdorur për të identifikuar humbjet financiare nga një rrezik i caktuar në një moment të caktuar gjatë një cikli të prodhimit. Qasja e shqyrton atë që po ndodh në industri dhe mat të hyrat e pritura neto të humbura si një moment specifik për shkak të ndikimit të rrezikut të caktuar. Projekti pilot specifik i industrisë ka shqyrtuar përdorimin e L





7.6. Kooperativat

Kohët e fundit, Swiss Re Corporate Solutions ka zhvilluar një produkt të ri për kooperativat në Spanjë. Produkti garanton të ardhurat, jo vetëm pasuritë. Në këtë mënyrë, humbjet mbulohen në bazë të aktivitetit ekonomik përgjatë zinxhirit të furnizimit ose koston së produktit përfundimtar. Për shembull, produkti i sigurimit mund të ofrojë mbulim për rreziqet që lidhen me përpunimin dhe marketingun e pemëve, jo vetëm rreziqet që lidhen me prodhimin e tyre. Një shembull i ofruar nga Swiss Re është në rastin e një kooperative që ka kosto të larta fikse në mirëmbajtjen e objekteve të ruajtjes në frigorifer për ruajtjen e pemëve. Kur ka mungesë në prodhim, objekti nuk përdoret në kapacitetin e tij të plotë dhe kjo mund të çojë në humbje të mëdha ekonomike. Në thelb, agrobizneset i mbrojnë fitimet e tyre të biznesit në rastin e dëmeve të mëdha. Për t'i trajtuar shqetësimet në lidhje me disponueshmërinë e të dhënave, Swiss Re përdor statistika të grumbulluara nga kooperativat ose agrobizneset dhe jo statistikave qeveritare në nivel provincë. Kjo jep një tregues më të saktë të të ardhurave normale të biznesit, në vend që të përpriqet ta standardizojë atë të disa biznese, të cilat njihet se ndryshojnë ndjeshëm.

7.7. Humbja e cilësisë

Kolumbia Britanike, Kanada

Në Kanada, në provincën e Kolumbisë Britanike, ekziston mbulim i veçantë për humbjen e cilësisë së pemëve. Ky sigurim mbulon humbjen në klasën e frutave të tregut kur breshri ose era e ashpër ka dëmtuar kulturën dhe e ka ulur cilësinë e pemëve të dorëzuara në treg. Dëmet e humbjes së cilësisë vlerësohen duke përdorur klasat e tregut bazuar në rregulloret kanadeze të pemëve dhe perimeve të freskëta. Pema me cilësi të dëmtuar vlerësohet dy herë, duke përfshirë edhe të parën duke mos i marrë parasysh dëmet, dhe pastaj të dytën duke marrë parasysh dëmet. Humbjet që dalin nga rreziqet përveç breshërit ose erës, të tilla si acari ose dëmtimi nga dimri nuk mbulohen, dhe në vend të kësaj, duhet të zgjidhet mbulimi i humbjes së rendimentit. Kulturat që janë të dëmtuara në fillim të vitit duhet të vazhdojnë të menaxhohen normalisht deri në vjetërimin e kulturës, duke përfshirë edhe vjeljen e pemëve deri në ngarkesë normale të kulturës.

Quebec dhe Ontario, Kanada

Në provincën Quebec, mullët mbulohen me një polisë të prodhimit. Mbulimi bazë mbron nga rreziqet e shumta të tilla si kafshët e egra, përmbytjet, era e tepruar, acari, breshëri etj. Mbulimi bazë është në dispozicion për fermat tradicionale dhe organike dhe përveç mbulimit bazë ekziston një opsion i shumë rreziqeve dhe një opsion i cilësisë së breshërit. Opsioni me shumë rreziqe siguron nga humbja e cilësisë së mollës për shkak të rreziqeve të shumëfishta. Opsioni i humbjes së cilësisë nga breshëri siguron nga humbja e cilësisë për shkak të breshërit. Prodhuesit organikë nuk kanë të drejtë për asnjë nga këto mundësi. Ngjashëm, në Ontario, Kanada, mullët janë të siguruar kundër shumë rreziqeve në prodhim.

Në SHBA, ekziston sigurimi i prodhimit për rendimentin dhe ka mbulim opsional për korrigjimet e cilësisë dhe ndryshon sipas llojit të kulturave.



7.8. Sigurimi i bazuar në indeks

India

India është e mirënjohur për produktet e sigurimit të bazuar në indeks për bujqësi. Të dhënat prirjen të jenë shumë më të përhapura për kulturat e tjera bujqësore, siç janë drithërat, megjithatë, për pemët dhe perimet shpesh nuk ka të dhëna në dispozicion. Prandaj, sigurimi i bazuar në indeks është parë si një zgjidhje e mundshme. Skema e bazuar në indeks është quajtur Skema e Sigurimit të Kulturave e Bazuar në Kushtet Klimatike të Modifikuara. Dëshmipërblimi i paguar për prodhuesit bazohet në luhatjet e motit.

7.9. Ide të ardhshme - Blockchain

Teknologjia Blockchain mund të përdoret për të menaxhuar të dhënat digjitale për një shumëllojshmëri të mallrave bujqësore, duke përfshirë të dhënat e sensorëve të bujqësisë precize, të dhënat e stacioneve të motit, të dhënat e cilësisë dhe të rendimentit, të dhënat logjistike dhe të dhënat financiare etj., të cilat mund të shtohen në të dhëna në kohë reale përmes teknologjive të internetit të gjërave (IoT). Përveç kësaj, sipas dizajnit, teknologjia blockchain lehtëson ndarjen e të dhënave ndërmjet palëve të interesuara dhe është rezistente ndaj modifikimit të të dhënave bazë.

Një blockchain është një listë në rritje e të dhënave digjitale, ku çdo e dhënë ruhet si një bllok që përbëhet nga 1) një hash kriptografik i bllokut të mëparshëm, 2) një grup të renditur të të dhënave, dhe 3) një vullë kohore. Hash kriptografik është komponenti kyç i sigurisë së blockchain-it sepse hash i secilit bllok vijues është i varur nga hash i bllokut të mëparshëm dhe çdo ndryshim në të dhënat që i përmban një bllok i caktuar do të prekte të gjitha blloqet e tjera që pasojnë brenda zinxhirit. Blockchain përdor një qasje të decentralizuar dhe të shpërndarë për ta ruajtur bazën e të dhënave, duke përdorur një rrjet të palëve të tjera për ta përsëritur menjëherë blockchain-in në të gjitha nyjat brenda rrjetit. Në mënyrë që një bllok i ri të shkruhet në zinxhir, blloku duhet së pari të vërtetohet nga një algoritëm konsensusi, ku rrjeti i palëve e vërtetojnë kërkesën. Kur plotësohet një kërkesë nga një përdorues për ta shtuar një bllok të dhënash të ri në zinxhir, blloku nënshkruhet duke përdorur kriptografinë publike/private, shërben si një regjistër i përhershëm i identitetit të përdoruesit. Në blockchain të lejuar (ose privat), kontrolli mbi lejet e leximit dhe shkrimit që kërkohen që një përdorues të bashkëveprojë me blockchain është i kontrolluar nga një grup pronarësh që e administrojnë algoritmin e konsensusit.

Një shembull i aplikacionit për blockchain për sigurim quhet kontrata e mençur (smart). Baza e një kontrate sigurimi është i siguruari që pajtohet të paguajë një prim për një premtim të ardhshëm nga siguruesi për ta mbuluar rrezikun dhe për të paguar një dëshmipërblim për ta mbuluar humbjen e mundshme. Mund të ketë shumë sfida në procesin e sigurimit, siç janë rreziku moral dhe përzgjedhja e pafavorshme. Rreziqet morale janë mungesa e besimit ku i siguruari e ndryshon sjelljen e vet pas kërimit të mbulimit të sigurimit, dhe përzgjedhja e pafavorshme janë vështirësitë e siguruesit në vlerësimin e profilit të vërtetë të rrezikut të të siguruarit, të cilat mund të çojnë në vendosje të çmimit më të lartë ose më të ulët. Në rastin e një kontrate "smart", lloje të reja të polisave të sigurimit mund të jenë në gjendje të zhvillohen dhe/ose mund të realizohen efikasitete dhe saktësi të reja. Një kontratë smart automatizon shumë aspekte të kontratës së sigurimit, duke lejuar vlerësimin e menjëhershëm dhe të saktë të rrezikut për shkak të regjistrave të hollësishme për secilin klient, shpenzimet më të ulëta të administrimit pasi ka më pak nevojë për persona që e përgatisin anën administrative të sigurimit, çmime më të sakta sepse siguruesi i njeh rreziqet dhe e di se çfarë duhet të kërkojë, dorëzimi dhe procesimi automatik i kërkesave, vlerësimi i saktë i kërkesave dhe llogaritja e kostos së dëmeve për shkak të të dhënave të besueshme të jashtme, zbulimi i shpejtë i mashtrimit dhe pagesat automatike në rast humbjeje.

Në rastin e bujqësisë, teknologjia blockchain ka mbetur relativisht e pahulumtuar. Blockchain bën një zinxhir furnizimi më transparent, dhe disa kërkime kanë diskutuar përdorimin e tij për sigurinë e ushqimit dhe gjurmueshmërinë. Në zinxhirin e furnizimit të ushqimit, informacioni lidhet në mënyrë digjitale me një produkt ushqimor dhe futet në blockchain në çdo pikë të vetme të udhëtimit të tij. Kjo mund të përfshijë detajet e origjinës së fermës, numrat e grumbullit, të dhënat e përpunimit, informacionet e fabrikës, datat e skadimit, temperaturat e ruajtjes në depo dhe detajet e dërgimit. Në rastin e sigurimeve bujqësore, ka hulumtime shumë të pakta.

Një zbatim i mundshëm i teknologjisë blockchain në rastin e sigurimit bujqësor është në lidhje me zhvillimin e dizajneve më të sakta dhe inovative të sigurimeve bazuar në indeks. Kujtojmë se sigurimi i bazuar në indeks përdor burime të ndryshme të të dhënave dhe algoritme për ta përgatitur kërkesën dhe për ta llogaritur dëmshpërblimin automatikisht. Premisa është se indeksi themelor është në korrelacion shumë të lartë me humbjen aktuale. Për shembull, në rastin e një kontrate sigurimi nga thatësia të bazuar në indeks, nëse temperatura bie për një sasi të caktuar për më shumë se një numër të përcaktuar të ditëve, fermeri merr një pagesë. Me një kontratë "smart", në fund të verës, në qoftë se moti ka qenë mbi pragun e specifikuar për më shumë se sa numri i përcaktuar i ditëve, kontrata do të jepte automatikisht një pagesë dëmshpërblimi për fermerin. Kontratat "smart" bazuar në teknologjinë blockchain mund të jenë veçanërisht të dobishme në vendet në zhvillim pasi që mungesa e të dhënave është në mënyrë tipike shqetësim dhe siguruesit shpesh përballen me kosto administrative relativisht të larta. Prandaj, blockchain mund të ndihmojë në zgjidhjen e këtyre çështjeve duke automatizuar procesin e sigurimit dhe duke e bërë procesin më ekonomik.

Në rastin e kultivuesve të pemëve dhe perimeve, teknologjia blockchain, së bashku me sensorë të ndryshëm dhe lidhje të internetit, mund të ofrojë mundësi të reja për të gjetur në mënyrë të sigurt sasi të mëdha të të dhënave dhe informacione që mund të jenë të vlefshme në përcjelljen e cilësive sasiore dhe cilësore, si dhe të dhënave të tjera për të ardhurat, të cilat mund të shërbejnë si bazë për një produkt të ri sigurimi.




8.o. Përmbledhje dhe rekomandime

Qëllimi i këtij doracakut ishte që të ofrojë një prapavijë dhe një pasqyrë të sektorit të pemëve dhe perimeve për ta përmirësuar të kuptuarit e kërkesave për zhvillimin e sigurimeve për kultivuesit e pemëve dhe perimeve. Fokusi kryesor i doracakut ishte në karakteristikat e cilësisë dhe humbjes, gjë që e bën veçanërisht të vështirë zhvillimin e sigurimeve për këtë sektor. Doracakut gjithashtu përfshin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të llojeve të ndryshme të produkteve të sigurimeve që mund të shqyrtohen për pemë dhe perime, duke përfshirë shembuj specifikë bazuar në përvojën ndërkombëtare.

Ndërsa duket se ka më shumë theks në zhvillimin e zgjidhjeve të reja dhe më efektive të menaxhimit të rrezikut dhe sigurimeve, doracakut diskuton disa sfida në dizajnimin, shitjen dhe shërbimin e sigurimeve të kulturave të specializuara në krahasim me kulturat më homogjene. Vështirësitë përfshinin përcaktimin e saktë të rendimentit afatgjatë të prodhimit, vlerësimin e cilësisë, vjeljet e shumëfishta të kulturës gjatë kohës, sipërfaqen relativisht të vogël, praktikatat shumë të ndryshme të prodhimit, mungesën e zbulimit të çmimeve për disa mallra, përzgjedhjen e pafavorshme dhe rrezikun moral, rreziqet specifike si dhe rreziqet që nuk lidhen me kushtet atmosferike. Prandaj, nevojiten përpjekje më të mëdha kërkimore dhe zhvillimore për të bërë përmirësime kuptimplota në sektorin e kulturave të specializuara.

Rekomandohet që përpjekjet për zhvillim në vendet në zhvillim të përqendrohen në politikatat me një rrezik të vetëm për pemët dhe perimet si një pikënisje për të fituar përvojë në sigurimin e rreziqeve në këtë sektor të specializuar. Kjo mund të përfshijë sigurime individuale, ose përndryshe me bazë të indeksit që mund të ofrojë efikasitet në sigurim dhe çështjet administrative në disa raste. Kjo do të mundësojë zhvillimin e mëtejshëm të standardeve të sigurimit, standardeve të klasifikimit, faktorëve të cilësisë, modeleve të çmimeve dhe çështjeve të tjera aktuariale. Rekomandohet që puna e ardhshme të marrë në konsiderim zhvillimin e politikave të bazuara në të ardhura për të trajtuar boshllëqet e mundshme në mbulim, duke përfshirë dizajnimin e sigurimeve të fermës në tërësi. Gjithashtu, duhet të monitorohen avancimet teknologjike, duke përfshirë përdorimin e blockchain-it, që mund të çojë në mundësi të reja për këtë sektor.



9.0. Referencat

Shërbimi i Marketingut Bujqësor (AMS). 2018. Në dispozicion online në:

<https://www.ams.usda.gov/grades-standards/fruits>

Bujqësia dhe Agro-ushqimore në Kanada (AAFC) 2012. Vlerësimi i agro-sigurimeve, partneritetet e menaxhimit të rrezikut në sektorin privat dhe programet e kompensimit për kafshët e egra. Në dispozicion online: <http://www.agr.gc.ca/eng/about-us/offices-and-locations/office-of-audit-and-evaluation/evaluation-reports/evaluation-of-the-agriinsurance-private-sector-risk-management-partnerships-and-wildlife-compensation-programs/?id=1367338599421>

Ali, J., & Kapoor, S. (2008). Perceptimi i fermerëve për rrezikun në prodhimin e pemëve dhe perimeve: Një studim empirik nga Uttar Pradesh. Revista e hulumtimeve të ekonomisë bujqësore, 21(2008). C.R.C., c. 285. 2018. Në dispozicion online në:

http://laws-lois.justice.gc.ca/eng/regulations/C.R.C.,_c._285/FullText.html

Ge, L., Brewster, C., Spek, J., Smeenk, A., dhe Top, J. (2017). Blockchain për bujqësi dhe ushqim: Gjetjet nga pilot studimi, Hulumtimi ekonomik Wageningen. <https://doi.org/10.18174/426747>.

Sciabarrasi, M. 2018. Pesë rreziqet më të mëdha me të cilat përballen fermerët. Në dispozicion online në: <https://nevegetable.org/big-five-risks-faced-farmers>

Sherrick, B. J., Barry, P. J., Ellinger, P. N., & Schnitkey, G. D. (2004). Faktorët që ndikojnë në vendimet e fermerëve për sigurimin e kulturave. Gazeta Amerikane e ekonomisë bujqësore, 86(1), 103-114.



Informatat e kontaktit: Korporata
Financiare Ndërkombëtare 2121
Pennsylvania avenue, NY
Washington, DC 20433, USA
www.ifc.org

